

Zaevi dhe Ahmeti në kërkim të kandidatit konsensual

Fq.3



GRUPIM I RI POLITIK
Gashi heq dorë nga BESA, partia do të quhet AKP

Fq.3



Speciale
Kosova 11 vjet shtet

Fq.12-15



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3587 · e hënë, 18 shkurt 2019

-1°C | 13°C

15 DEN



KOHA për sport

Fq.16-19

AKTUALE

Nuk ka ndryshim kufijsh të Maqedonisë së Veriut



Në bisedë me Deutsche Wellen, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev lidhur me debatin për ndryshim kufijsh mes Kosovës e Serbisë theksoi, se pas zgjidhjes së problemit të Maqedonisë së Veriut me Greqinë, tani mbeten çështja e Kosovës dhe Bosnja si problemet që duhen zgjidhur. "Ja pse ne e mbështetim çdo zgjidhje dhe do të promovojmë..."

Fq.4

GLOBI

Merkel dhe Mike Pence: Kur dy botë përplasen

Fq.9

SPECIALE

Dielli shkëlqen për turkun ashtu edhe për të krishterët

Fq.20-21



EMIGRIMI SI ALTERNATIVË

TË RINJTË IKIN, SHTETI S'KA STRATEGJI



Sipas raportit të fundit të BB-së, dhjetë vitet e fundit jashtë Maqedonisë jetojnë dhe punojnë më shumë se 29 për qind e personave me arsim të lartë, ndërsa në përgjithësi numri i të rinjve që çdo ditë po ikin nga Maqedonia shkon deri në 21 për qind. Kështu rezulton raporti i fundit i Bankës Botërore (BB). Pagat e ulëta, mungesa e mundësisë për trajnim dhe zhvillimit të karrierës, pengesat për kualifikime akademike dhe besueshmëria personale, mungesa e lirisë në hulumtime, izolimi nga debatet akademike ndërkombëtare, janë shkaqet kryesore e "ikjes së trurit"

Fq.5

Siguria nëpër rrugë, larg mesatares evropiane

Shkup, 17 shkurt - Maqedonia vite me radhë ka shkallë të lartë të aksidenteve në trafik që përfundojnë me pasoja fatale. Maqedonia në shtatë vitet e kaluara apo përgjatë periudhës 2011-2018 ka një numër të lartë të aksidenteve në trafik që përfundojnë në mënyrë tragjike si shoferë, bashkudhëtarë dhe këmbësorë. Në vitin 2011 ka pasur 172 viktima, në vitin 2012 ka pasur 132 viktima, në vitin 2013 - 198, në vitin

2014 - 130, në vitin 2015 - 148, në vitin 2016 - 165, në vitin 2017 - 155 dhe në vitin 2018 janë shënuar 129 viktima. Në Maqedoni, vite me radhë ndërmerren aksione të ndryshme parandaluese, fushata për zvogëlimin e kësaj dukurie negative nga organe të ndryshme si MPB, Këshillit Republikan për Siguri në Komunikacionin e Rrugëve si organ konsulent e kështu me radhë, por megjithatë - akoma është...

Fq.6



URIME

11 vjetori e gjen Kosovën para sfidave përfundimtare

Kreu i BDI-së, Ali Ahmeti, ka uruar të gjithë shqiptarët me rastin e 11 vjetorit të pavarësisë së Kosovës. "11 vjetori i pavarësisë së Republikës së Kosovës e gjen shtetin më të ri në Evropë para sfidave përfundimtare të shtetndërtimit. Secili nga ne ka dhënë kontribut në arritjen më të madhe kombëtare, shtetin e lirë, demokratik dhe të pavarur të Kosovës. Kjo, pa dyshim u arrit edhe me ndihmën e pakusyer të miqve tanë ndërkombëtar nga komuniteti euroamerikan". ka shkruar Ahmeti në urimin e tij në Facebook. Andaj, thotë tutje ai, dhe secili nga ne që ka punuar për këtë



ditë, sot dëshiron ta shoh këtë të arritur tonë të përbashkët, Kosovën, të anëtarësuar në OKB, NATO dhe BE, me fqinjësi të mirë, të zhvilluar dhe të mirëqenë.

Thaçi uron pavarësinë e Kosovës

Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare, Menduh Thaçi, i ka dërguar telegram urimi kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të parlamentit, Kadri Veseli me rastin e përvjetorit të pavarësisë së Kosovës. "Në këtë përvjetor të rëndësishëm për mbarë kombin shqiptar, urojmë që Kosova shumë shpejt të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Në emrin tim personal dhe në emër të PDSH-së ju uroj juve dhe gjithë shqiptarëve që këtë ditë ta kremtojmë me krenari dhe me besim të plotë për një të ardhme më të mirë për të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë".




Kasami uron 11 vjetorin e pavarësisë së Kosovës

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, ishte kurorëzimi i një rrugëtimi të dhimbshëm sakrificash dhe derdhje lotësh e gjaku për të arritur idealin historik, pavarësinë e Kosovës, shkruan në telegram urimin e kryetarit të BE-SËS, Bilall Kasami. "Sot Kosova gëzon pavarësinë e saj, e cila është mbështetur dhe njohur nga shumë vende të botës. Mundi dhe sakrificat ka qenë shumë e madhe, madje dikush ka sakrifikuar edhe jetën që sot Kosova të jetë e lirë dhe e pavarur. Në emrin tim personal dhe në emër të Lëvizjes BESA më lejoni të uroj 11 vjetorin e pavarësisë së Kosovës, qoftë gjithmonë e fortë dhe stabile. Data të tilla janë të ngulitura në zemrat tona, duke i përkujtuar si data që ndërtuan historinë tonë të lavdishme kombëtare".




Marrëveshja me njohje reciproke do të sillte stabilitet

Aleanca për Shqiptarët, me kryetarin e vet Ziadin Sela ka uruar popullin e Kosovës me rastin e 11 vjetorit të Pavarësisë. "Shteti i Kosovës lindi falë përpjekjeve të vazhdueshme, sakrificës dhe gjakut të shqiptarëve ndër shekuj. Kjo betejë vazhdon deri më sot, jo më për lirinë e Kosovës, por për konsolidimin e sovranitetit të saj të brendshëm e të jashtëm dhe për të ardhmen e saj euroatlantike, si shteti i barabartë i bashkësisë ndërkombëtare. Një Kosovë e integruar jashtë dhe brenda, e unifikuar politikisht, në koordinim me SHBA dhe Bashkimin Evropian do t'i tejkalojë të gjitha sfidat dhe vështirësitë në bisedimet me Serbinë për arritjen e një marrëveshjeje juridikisht detyruese për njohje reciproke", thuhet në urimin e kësaj partie. Vetëm një marrëveshje e tillë, thuhet tutje, do të sillte siguri dhe stabilitet të përhershëm në rajon dhe perspektivë evropiane për dy shtetet dhe mbarë Ballkanin Perëndimor.




TREGTIMI I KUFIJVE DHE PAVARËSIA

"Të dashur miq, sot Kosova, qytetarët e saj, mbarë kombi shqiptar dhe miqtë e saj në mbarë botën festojnë 11 vjetorin e Pavarësisë. Ditëlindja e Republikës së Kosovës fton shqiptarët të përulën me nderimin më të thellë para qindra mijëra bijve dhe bijave të saj që vendosën në themelet e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, jetën dhe rininë e tyre si dhe të gjithë atyre që luftuan dhe sakrifikuar në dekada e dekada për lirinë dhe dinjitetin e saj kombëtar. Pavarësia e Kosovës është vepër e gjenit politik të kombit tonë, presidentit Ibrahim Rugova, arkitektit dhe udhëheqesit mendjendritur të pavarësisë së Kosovës, Komandantit legjendar Adem Jashari, kryeheroit të kombit pas Skënderbeut dhe aleateve tanë me në krye SHBA, të cilët me fuqinë e tyre ushtarake ajrore mposhtën dhe detyruan të kapitullojë kasapin e Beogradit, Slllobodan Millosheviçin. Por sot pas 11 vitesh liri dhe pavarësi Kosova përballet me një rrezik të madh të copëtimit të trojeve të saj. Argatë të Beogradit në Prishtinë dhe Tiranë kanë marrë në dorë flamurin e Serbisë së Madhe dhe tregtojnë në emër të tij territoret e saj. Këta esadistë, miladinë e zografë albanofobe duan ti bëjnë Kosovës sot atë që nuk guxoi ti bënte as Slllobodan Millosheviçi. Ky qëndrim antikombëtar i argatëve të Beogradit është sot një kushtim për çdo shqiptar për të mbrojtur Kosovën prej tyre si dhe çdo pëllëmbë të territorit të saj. Gëzuar Kosovë 11 vjetorin e Pavarësisë!", shkruan në profilin e tij në Facebook, ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha.



KUSH UA HA BUKËN TË BURGOSURVE NË IDRIZOVË

"Të burgosurit e mbajnë shpirtin gjallë me ushqimin që e marrin nga shtëpitë pasi ushqimin që e përgatisin në burg vetëm derrat munden ta hanë. Me një kazan 'gjellë' këllinjë kalohet i gjithë burgu, edhe pse çdo të burgosuri i takojnë 2000 kalori në ditë. Të burgosurit vishen vetë edhe pse ligji u garanton atyre veshmbathje. Dikush i vjedh këto para. Gjatë këtyre 28 viteve Veriorja ka marrë disa qindra milionë Euro për përmirësimin e kushteve nëpër burgje. Mos vallë i ndajnë donatorët dhe hajdutorët? Nuk ka mundësi që donatorët të mos kontrollojë ku shkojnë paratë e tyre. Ku është Avokati i Popullit, ku është Drejtoria për Zbatimin e Sankcioneve Komiteti i Helsinkit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, Komisioni anti-korrupsion, Komisioni kundër diskriminimit dhe disa subjekte që hanë bukë në emër të burgosurve dhe të diskriminuarve? Një i burgosur e lë pa bukë të gjithë familjen. Thirrini mendjes ju që jeni kompetent. Do të ju vrasë buka e fukarait. Çdo e keqe lahet në këtë botë", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti Shpëtim Pollozhani.



MEDIACitate

BEOGRADI PROMOVUHEN SHTETET QË E KANË ÇNJOHUR KOSOVËN

Ministri serb i Punëve të Jashtme, Ivica Dačić, sot ka marrë pjesë në atë që ai e ka quajtur promovim të shteteve që e kanë çnjohur pavarësinë e Kosovës. Dačići me këtë rast ka thënë se Serbia ia ka dalë që çështjen e Kosovës ta kthejë në rend dite dhe ka shtuar se Serbia lidhur me statusin e Kosovës nuk do të bëjë asgjë që do të rrezikonte interesat shtetërore të Serbisë, ndërsa ka paralajmëruar se do të vazhdojë me përpjekjet për çnjohje të Kosovës. Sipas Dačićit, SHBA-ja e ka ndryshuar qëndrimin për Kosovën, pasi, ka thënë ai, Washingtoni tash po angazhohet për kompromisin ndërmjet Kosovës e Serbisë. Duke folur për 11 vjetorin e pavarësisë së Kosovës, siç përcjell FoNet, Dačić ka thënë se "qëkur është ministër, vetëm 9 vende e kanë njohur pavarësinë e Kosovës ndërsa 13 sosh e kanë tërhequr këtë njohje. Ai ka thënë se gjatë 11 vjetëve të pavarësisë, Kosova nuk ia doli të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës, OKB-së dhe as e UNESCO-s e Interpolit. Para promovimit të shteteve që e kanë tërhequr njohjen, është emetuar muzikë nga ato vende, ndërsa pjesëmarrësve u është dhuruar çokollatë e mbështjella me famujt e atyre vendeve. Sipas Dačićit, njohjen e Kosovës e kanë tërhequr Sao Tome e Principe, Suriname, Guineja Bisao, Burundi, Liberia, Papu Guineja e Re, Lesoto, Komonvelthi Dominika, Unioni i Komoreve, Ishujt Solomon, Madagaskari, Palau dhe Grenada.

(Koha.net, 17 shkurt)

SERBIA REFUZON PROPOZIMIN E SHBA-së

Beogradi nuk do ta pranojë propozimin e SHBA-së për ta njohur pavarësinë e Kosovës, ashtu siç i ka shkruar presidenti amerikan Donald Trump presidentit të Serbisë, Aleksandar Vučić, transmeton Koha.net. Pala serbe propozimin nga Shtëpia e Bardhë dhe Platformën për dialog i ka parë si veprime të sinkronizuara në mënyrë që Serbinë ta vërë para aktit të kryer për ta njohur pavarësinë e Kosovës dhe që si shpërbllim Serbisë t'i ofrohet anëtarësimi i përsheptuar në BE - si dhe opsioni i hapur për hyrje në NATO. "Se shpresat për njëfarë ndryshimi të qëndrimit të SHBA-së janë vetëm ëndrra, e ka dëshmuar edhe urimi i Trumpit për Serbinë e Kosovën", konstaton gazeta dhe rikujton se "dy urimet njësoj, kërkojnë marrëveshje me njohje të ndërsjellë".

(Novosti, 17 shkurt)

Sot (e hënë) do të takohen kryeministri dhe lideri i LSDM-së, Zoran Zaev dhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti për të biseduar për një kandidatë të mundshëm konsensual për president. Më pas, Zaevi pritet ti vijojë takimet edhe me liderët tjerë politik shqiptarë me qëllim që të arrihet një zgjidhje kompromisi. Nëse arrihet marrëveshje, atëherë në Konventën e LSDM-së më 3 mars formalisht do të konfirmohet vetëm kandidati i përbashkët, i cili siç thotë Kostadinov, do të jetë konsensual

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE DHE PARTITË SHQIPTARE ZAEVI E AHMETI NË KËRKIM TË KANDIDATIT KONSENSUAL



VMRO ME SILJANOVSKËN NË ZGJEDHJET PRESIDENCIALE

Gordana Siljanovska, profesoreshë e Fakultetit Juridik në Universitetin e Shkupit është kandidatja zyrtare e VMRO-DPMNE-së për presidente në zgjedhjet presidenciale që duhet të mbahen edhe dy muaj. Siljanovska ka marrë mbështetjen e shumicës së delegatëve të Kuvendit zgjedhor të VMRO-së që të shtunën u mbajt në Strugë. Për Siljanovskën kanë votuar 408 delegatë nga 520 gjithsej, ndërsa kryetari i VMRO-së, Hristijan Mickovski u shpreh me se Siljanovskën, fitorja është e sigurt. Ndryshe, Siljanovska kishte mbështetjen edhe të profesorëve dhe intelektualëve maqedonase. Javë më parë, 30 profesorë universitar kishin firmosur mbështetjen e Siljanovskës për presidente të vendit, ndërsa thirrja për mbështetjen i drejtohet dy partive maqedonase - VMRO dhe LSDM. Ndër të parët që kanë firmosur mbështetjen për Siljanovskën gjendet edhe Biljana Vankovska dhe Karolina Ristovska Asterud, profesorë universitar më antishqiptarë që mund të gjenden në Universitetin e Shkupit, ndërsa hapur janë shprehur edhe ndaj Ligjit për gjuhën shqipe. Mbështetje Siljanovskës i ka dhënë edhe Jani Bojaxhi, regjisori që në filmin e tij të fundit "Tallja e Krishtit", Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare e paraqiti si ushtri monsturoze.



Koha Destan JONUZI

Shkup, 17 shkurt - Kandidati konsensual për presidenti, ide kjo të cilën e ka promovuar Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI), dhe e mbështetur nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM), edhe mëtej është temë aktuale në skenën politike, pak muaj para mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale, të cilat tanimë i ka shpallur kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi. Nga LSDM-ja për gazetën KOHA thonë se fillimisht për kandidatin konsensual për president do të diskutojnë me partnerët më të vegjël të koalicionit që janë nën "ombrellën" e LSDM-së dhe më pas - do të diskutojnë edhe me partnerët e koalicionit dhe partitë tjera shqiptare.

"Fillimisht do të bisedojmë me partitë që janë në koalicion me LSDM-në dhe më pas edhe me partnerët e koalicionit dhe partitë tjera shqiptare. Konkursi për para-

qitjen e kandidatëve është i hapur deri më 19 shkurt, ndërsa me 3 mars e kemi Konventën partiake ku duhet ta caktojmë edhe kandidatin për president", deklaroi zëdhënësi i LSDM-së, Kostadin Kostadinov. I pyetur se në rast se arrihet ndonjë kompromis për kandidatin konsensual, sa kandidatë do të ketë në Konventën e 3 marsit, ai u përgjigj se atëherë vetëm një kandidatë do të ketë.

"Nëse kemi një marrëveshje dhe arrijmë kompromis për një kandidatë të përbashkët edhe me partitë shqiptare, atëherë në Konventën partiake do të kemi një kandidatë i cili do të verifikohet", theksoi Kostadinov. Ndërkohë, Bujar Osmani, zyrtarë i lartë i BDI-së, thotë për gazetën KOHA se qëllimi i takimit Zaev-Ahmeti është që të arrihet një marrëveshje. "Takimi i kryetarit Ahmeti dhe kryeministrit do të mbahet sot (e hënë) në Klubin e deputetëve. Ulemi për të gjetur një kompromis", deklaroi

Osmani. Nga Aleanca për Shqiptarët (ASH) e Ziadin Selës thonë se kreu i kësaj partie Ziadin Sela është i autorizuar të zhvillojë bisedime me të gjithë aktorët politik për temën e zgjedhjeve presidenciale.

"Kryesia Qendrore e ASH-së e ka autorizuar liderin e partisë, Ziadin Sela, të zhvillojë bisedime me të gjithë aktorët politik në vend për temën e zgjedhjeve presidenciale, por vendimet për negociatat eventuale do ti marrin organet e partisë (Kryesia Qendrore dhe Kuvendi Qendror), që do ta merrte vendimin më të mirë të mundshëm në interes të procesit politik. E rikujtojmë kryeministrin Zaev për kërkesën legjitime të ASH-së që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare krahas atyre presidenciale, do ta hapte mundësinë e dialogut dhe të negociatave me të gjithë subjektet politike, përfshirë edhe me kryeministrin Zoran Zaev", deklaroi për gazetën KOHA, Flakron Bexheti,

shefi i departamentit për Informim pranë ASH-së. Nga ana tjetër, nga Lëvizja BESA thonë se kjo parti është parti opozitare dhe se ka qëndrime të ndryshme nga partitë në pushtet. "Nuk ka patur ndonjë kërkesë nga Kryeministri Zaev për të diskutuar rreth një mundësie të tillë. Ne jemi parti opozitare dhe normalisht kemi qëndrime të ndryshme nga partitë në pushtet. Për momentin jemi duke punuar me gjithë faktorët politik shqiptar, klasën intelektuale dhe diasporën për të dalë me një zgjidhje që do faktORIZONTE në maksimum votën shqiptare", deklaroi Arjanit Hoxha, sekretar i përgjithshëm i Lëvizjes BESA.

Përndryshe, partia më e madhe opozitare maqedonase të shtunën është përcaktuar që ngjyrat e saj partiake në zgjedhjet presidenciale t'i përfaqësojë Gordana Siljanovskën, një profesoreshë universitare me qëndrime të ashpra antievropiane dhe antishqiptare. Ajo ishte kundër Marrëveshjes së

Prespës, kundër ligjit për gjuhën shqipe etj.

PAS HUMBJES SË BETEJAVE LIGJORE ME BESËN E KASAMIT

GASHI HEQ DORË NGA BESA, PARTIA DO TË QUHET AKP

Zyrtarizimi i partisë së re do të bëhet ditëve në vijim, ndërsa që të dielën nuk kanë munguar komentet për emrin e ri. "Alternativa Kombëtare Progressive - AKP, apo njëjtë sikurse AKP e presidentit turk, Erdogan", janë komentet që më së shumti hasen në rrjetet sociale

Shkup, 17 shkurt - Pas humbjes së betejave gjyqësore të Lëvizjen BESA të Afrim Gashi, duket se ky i fundit ka vendosur tashmë ta ndërrojë emrin e partisë, e cila edhe zyrtarisht i takon Bilall Kasamit. Është vendimi i Gjykatës së Apelit ajo që ka "detyruar" grupimin politik të Afrim Gashit të mendojnë dhe vendosin për emër të re të partisë, pasi emri "BESA" tashmë është e pjesë e Regjistrimit qendror të partive politike, por me kryetar Bilall Kasa-

min. Mediat raportojnë se Gashi ka njoftuar tashmë anëtarët e ngushtë të grupimit politik se duhet grumbulluar nënshkrime për partinë e re, ndërsa e njëjta do të quhet Alternativa Kombëtare Progressive (AKP). Zyrtarizimi i partisë së re do të bëhet ditëve në vijim, ndërsa që të dielën nuk kanë munguar komentet për emrin e ri. "Alternativa Kombëtare Progressive - AKP, apo njëjtë sikurse AKP e presidentit turk, Erdogan", janë komentet që më së

shumti hasen në rrjetet sociale. Ndryshe, Gjykata e Apelit, disa muaj pas "luftës" gjyqësore midis Kasamit dhe Gashit, i kishte dhënë të drejtë të parit në pronësinë e partisë. Tre ankesa tjera të Gashit ishin hedhur poshtë, ndërsa BESA me kryetar Bilall Kasamin tashmë është pjesë e Regjistrimit gjyqësor të partive politike, ndërsa e njëjta është publikuar edhe në Gazetën Zyrtare. Ndasitë midis dy grupeve kishin shpërthyer me mbajtjen e dy



Kongreseve, ndërsa ishte grupi i Gashit që, sipas vendimeve gjyqësore, padrejtësisë dhe në kundërshtim me Programin dhe Statutin e partisë, kishte shkarkuar Bilall Kasamin nga kreu i partisë dhe kishte zgjedhur

Afrim Gashin për kryetar. Veç AKP-së së Gashit, tashmë është formuar edhe partia "Populli" me kryetar Xhelil Bajramin, ish-ministër i Ekologjisë në kohën e PDSH-së në pushtet 2006-2008. (R.K)

Në Konferencën e Sigurisë që u zhvillua në Mynih, mori pjesë edhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev. Deutsche Welle e pyeti kryeministrin Zaev për debatin aktual të kufijve mes Kosovës e Serbisë

Mynih, 17 shkurt - Në bisedë me Deutsche Wellen, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev lidhur me debatin për ndryshim kufijsh mes Kosovës e Serbisë theksoi, se pas zgjidhjes së problemit të Maqedonisë së Veriut me Greqinë, tani mbeten çështja e Kosovës dhe Bosnja si problemet që duhen zgjidhur. "Ja pse ne e mbështesim çdo zgjidhje dhe do të promovojmë bashkëpunimin, të garantojmë paqen dhe çojmë përpara agjendën tonë dhe ajo është integrimi në BE. Dhe kjo është e mundur të arrihet. Nuk po hyj në detaje, sepse nëse dikush nga vendet fqinjë komenton detajet, kjo mund të kthehet në një problem. Kjo është çështje mes Beogradit dhe Prishtinës, unë besoj, se ata do ta gjejnë një zgjidhje. Shpresoj për një zgjidhje pozitive dhe miqësore, dhe dua t'i ndihmoj të dy presidentët dhe qeveritë e tyre".

Ndërsa i pyetur, nëse mund të ketë pasoja hapja e çështjes së ndryshimit të kufijve edhe për Maqedoninë, kryeministri Zoran Zaev tha se "tani ata vetëm mund të ëndërojnë për ndryshimin e kufijve të Maqedonisë Veriore. Ne

ZAEVI NGA KONFERENCA E MYNIHUT

NUK KA NDRYSHIM KUFIJSH TË MAQEDONISË SË VERIUT



BALLKAN SI VEND I RI I SHPRESËS

Kryeministrat e Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe të Greqisë, Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras, mbrëmë në Mynih e fituan çmimin "Ewald Fon Klajst". Nikoqir i ceremonisë ishte kryeministri i shtetit federal bavarian, Florian Herman. "Ewald fon Klajst" është çmim që ndahet për kontribut ndaj paqes dhe sigurisë botërore. "Ky është nder i madh për qytetarët e Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë", shënoi kryeministri Zaev


në profilin e tij në Facebook. Zaev dhe Cipras ishin përshëndetur me duartrokitje derisa e pranuan çmimin për kontributin e tyre në paqen ndërkombëtare dhe zgjidhjen e qetë të kontesteve përmes Marrëveshjes së Prespës. Sipas kryeministrin, Evropa dhe Ballkani sot bëhen një - Ballkan si vend i ri i shpresës, si vend për dialog dhe bashkësi, si vend për stabilitet dhe bashkëpunim.

jemi anëtar i NATO-s. Nuk do të ketë ndryshim kufijsh në Maqedoninë Veriore. Ne jemi të sigurt dhe anëtarësia në NATO na e jep këtë siguri". Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev në bisedë me Deutsche Wellen theksoi, se "qëllimi ynë i përbashkët është integrimi në BE, në zonën Shengen dhe

hapja e kufijve".

"Të jemi në një kufi të përbashkët evropian, kjo është gjëja më e rëndësishme. Nëse mendojmë në këtë drejtim, duhet të veprojmë në këtë mënyrë. Më në fund duhet të ndalim të mendojmë, se bota ka filluar të ekzistojë me kombetona. Jo. Ne mund të jemi të gjithë

më ambiciozë, të tregojmë më shumë solidaritet, të ndihmojmë më shumë njëri-tjetrin për një jetë më të mirë, ne kemi të gjithë vetëm një jetë. Dhe shumë varet nga politikanët. Nëse e lëmë mënjane nacionalizmin, do të jemi më evropianë dhe do të jetojmë më shumë një jetë europiane".



Në çdo konflikt mund të gjendet zgjidhje nëse ka guxim

Shkup, 17 shkurt - Kancelaria e Gjermanisë Angela Merkel ju dha mirënjohje kryeministrin të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe atij të Greqisë, Zoran Zaev dhe Alexis Cipras për guximin e tyre të arrijnë marrëveshje dhe ta tejkalojnë kontestin disa dekadash, duke i mundësuar në këtë mënyrë hyrje Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO. "Në çdo konflikt mund të gjendet zgjidhje nëse ka guxim", tha Merkel në konferencën e sigurisë në Mynih. Ajo mes tjerash, paralajmëroi që edhe bota multilaterale po rrenohet, dhe kjo nuk do të thotë që duhet të shkatërrohet. Merkel kritikoi politikën e kryetarit amerikan Donald Trump. "Duhet të luftojmë për Evropën, për multilateralizmin, kundër atyre që mendojnë se munden vetëm", tha Merkel. Berlini është i brengosur për bashkëpunimin multilateral pas tërheqjes së SHBA-së, pas disa marrëveshjeve të nënshkruara, përfshirë këtu edhe Marrëveshjen e Parisit për klimën dhe Marrëveshjen nukleare të Iranit, të dyja të firmosura në 2015. Ndryshe, kryeministri Zoran Zaev dhe kolegu i tij grek Aleksis Cipras në Mynih morën çmimin "Ewald von Kleist". Çmimi u dorëzua me ceremoni të veçantë në mbrëmje nikoqir i së cilës ishte kryeministri i Bavarisë, Florian Herman. Të dy kryeministrat në suaza të Konferencës të Sigurisë së Mynihut do të mbajnë fjalim në panel diskutimin e përbashkët. Kryeministrat marrin këtë çmim prestigjioz për shkak të zgjidhjes së problemit shumëvjeçar lidhur me çështjen e emrit.



Shkup, 17 shkurt - Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar lidhur me Maqedoninë do ta përdorë termin Re-

Mbretëria e Bashkuar e pranoi termin Maqedonia e Veriut

publika e Maqedonisë së Veriut, kumtoi sekretari i Punëve të Jashtme, Xheremi Hant. Në deklaratën e publikuar në faqen e internetit të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar është me rastin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Prespës mi-

dis Greqisë dhe Maqedonisë, Hant thekson se ky është një moment historik për të dyja vendet. Në deklaratë edhe theksohet se edhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka marrë kërkesë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

ta pranojë dhe përdorë emrin dhe termet e nënvizuara në nenin 1 (3) të Marrëveshjes së Prespës. Në këtë drejtim Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me Maqedoninë do ta përdorë termin Republika e Maqedonisë së Veriut.

Bajden mbështet politikën euroatlantike të Maqedonisë së Veriut

Shkup, 17 shkurt - Ish-nënpresidenti i SHBA-ve, Xho Bajden në takim e djeshëm me kryeministrin Zoran Zaev në Konferencën e Sigurisë në Mynih, dërgoi urime të forta për statusin e ftesës së vendit në NATO dhe shfaqti gatishmëri të fortë ta mbështesë ratifikimin e Protokollit në Kongresin amerikan dhe t'i inkurajojë përfaqësuesit parlamentarë të vendeve të tjera anëtare të NATO-s ta bëjnë ata sa është e mundur më shpejt.

"Bajden ka theksuar se sukcesi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të politikave të SHBA-së

dhe të Bashkimit Evropian, dhe se i gëzohet ditës kur do të përmbillet ratifikimi i Protokollit dhe kur Republika e Maqedonisë së Veriut do të bëhet partner i barabartë sipas rëndësisë me aleatët e tjerë në NATO", kumtoi pres shërbimi qeveritar për takimin e Zaevit dhe Bajdenit, ku kryeministri dhe anëtarët e delegacionit - ministrja Radmila Shekerinska dhe Nikolla Dimitrov, kanë shprehur falënderim për mbështetjen që në të gjithë procesin për zgjidhjen me sukses të kontestit me Republikën e Maqedonisë vinte nga SHBA-ja dhe për-

faqësuesit e tyre të lartë.

Zaev i shprehu falënderim Bajdenit për përpjekjet e tij për zgjidhjen e sukses të kontestit me Greqinë dhe për mbështetjen e Marrëveshjes së Prespës e cila e zhbllokoji procesin për partneritetin tonë në NATO, dhe i siguroi për politikën e vendit për aspiratat për anëtarësim sa më të shpejtë në BE. "Të dy bashkëbiseduesit në takim i kanë konfirmuar dhe afirmuar edhe perspektivat e ardhshme për bashkëpunim midis SHBA-së dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut në më shumë fusha me theks



të veçantë në çështjen e politikave të përbashkëta të sigurisë", informoi pres shërbimi qeveritar. Kryetari i Qeverisë sot realizoi takim

edhe me admiralin Xhejms Stavridis dhe ambasadorin Riçard Burt nga organizata konsultuese "Mek Larti Aosshejt".

EMIGRIMI SI ALTERNATIVË

TË RINJTË IKIN, SHTETI S'KA STRATEGJI

Sipas raportit të fundit të Bankës Botërore (BB), dhjetë vitet e fundit jashtë Maqedonisë jetojnë dhe punojnë më shumë se 29 për qind e personave me arsim të lartë, ndërsa në përgjithësi numri i të rinjve që çdo ditë po ikin nga Maqedonia shkon deri në 21 për qind. Kështu rezultoi raporti i fundit i Bankës Botërore (BB). Pagat e ulëta, mungesa e mundësisë për trajnim dhe zhvillimit të karrierës, pengesat për kualifikime akademike dhe besueshmëria personale, mungesa e lirisë në hulumtime, izolimi nga debatet akademike ndërkombëtare, janë shkaqet kryesore e "ikjes së trurit"



Kështu rezultoi sipas raportit të fundit të Bankës Botërore (BB), në të cilin, ndër shkaqet kryesore për "ikjen e trurit" janë pagat e ulëta, mungesa e mundësisë për trajnim dhe zhvillimit të karrierës, pengesat për kualifikime akademike dhe besueshmëria personale, mungesa e lirisë në hulumtime, izolimi nga debatet akademike ndërkombëtare, përballja e shtetit mosstabilitetin politik dhe ekonomia e keqe. "Migrimi ilegal vazhdon të mbetet njëri nga problemet themelore të institucioneve të Maqedonisë. Pavarësisht thirrjeve publike nga funksionarë të lartë shtetëror, se migrimi është sakrificë që nuk ia vlen, megjithatë ikja e të rinjve sidomos të atyre që kanë të kryer fakultete po vazhdon në mënyrë të heshtur, madje statistikisht në Maqedoni flasin për një ikje të madhe jashtë Maqedonisë", thuhet në ra-

portin e fundit të BB-së.

Edhe hulumtimet tjera të kryera nga shumë Organizata Joqeveritare (OJQ) në Maqedoni, zbulojnë se është i madh numri i të rinjve që ëndërrojnë të ikin nga Maqedonia për një jetë më të mirë.

"Shpërngulja e të rinjve pavarësisht se çfarë arsimit kanë, vazhdimisht është në rritje dhe se mbi 50 për qind e të anketuarve kanë shprehur ambicie për migrim në BE", thuhet në anketat e realizuar nga OJQ-të në Maqedoni.

Profesori Zhidas Daskalovski nga Qendra për Hulumtim dhe Krijimin e Politikave (QHKP) thotë se pamundësia e qytetarëve të Maqedonisë sidomos atyre me arsim të lartë për të gjetur punë në Maqedoni është edhe një faktor kryesor që ka bërë shumë të rinj të kërkojnë një jetë më të mirë jashtë vendit.

"Migrimi i kuadrove të larta profesionale është proces normal

në të gjitha vendet e botës. Kur kemi parasysh parametrat ekonomik dhe social në të cilët gjendet këto 10 vitet e fundit Maqedonia dhe me një vizion të paqartë për të ardhmen e tyre, është e natyrshme që do të dalin jashtë Maqedonisë", thotë Daskalovski.

Sa i përket veprimeve që duhet të ndërmerret qeveria aktuale që të parandalojë ikjen e të rinjve në vendet e ndryshme të BE-së, Daskalovski thotë se ofrimi i kushteve më të mira për jetesë, punësim, rroga më të larta, e shumë gjëra të tjera mund të kontribuonte në ndalimin e "Ikjes së trurit".

"Maqedonia duhet të bëjë përpjekje që politikën tatimore dhe kushtet e jetës për rinjtë t'i bëjë më të lehta që t'i mbajë kuadrot e lartë arsimor në mënyrë që ata të mos ikin jashtë vendit. Për fat të keq Maqedoni është larg kushteve të këtila, mbisundon nepotizmi dhe partizimi. I rëndësishëm është dhe vendosja e drejtësisë që do të kontribuonte në krijimin e kushteve më të mira që të rinjtë mos të shpërngulen në vendet të ndryshme të botës", thotë Zhidas Daskalovski nga QHKP. Për sociologun Ali Pajaziti shkaqet që qytetarët e Maqedonisë me arsim të lartë shpërngulen drejt vendeve të ndryshme të botës janë të shumta. Pamundësia për t'u vetërealizuar në një shoqëri skajshmërisht të korruptuar, ku vlerat dhe meritat nuk vlejnë

gjë prej gjëje, ku gjithçka, edhe punësimet në nivelet më të ulëta janë politizuar, ku nuk çmohen shkathtësitë e individit apo të kuadrove, por përkatësia njëjës apo tjetër proveniencë politike, sipas tij, janë disa nga shkaqet.

"Klima ekonomike dhe ajo politike gjithashtu ndikon shumë në braktisjen e vendit nga të rinjtë. Pagat tepër të ulëta, dilemat rreth ardhmërisë së vendit, tanimë paksa të zbutura, i bëjnë të rinjtë të ndjehen të pasigurt për t'i bërë planet e jetës këtu andaj i bëjnë diku tjetër, larg vendlindjes, pa të afërmit por afër meritokracisë dhe parave. Si do ketë ardhmëri kur njëri i duhet të vijë nga Gostivari në Shkup për 350 euro, me të cilat duhet ta paguajë rrugën, të ushqehet, të mbajë familje, të paguajë fatura e tjera", thotë Pajaziti. Sipas tij, mënyra e vetme që të parandalojë ikja e qytetarëve me arsim të lartë është që shteti duhet të bëhet i drejtë para së gjithash, t'i selektojë kuadrot sipas peshës së tyre intelektuale dhe profesionale.

"Duhet t'i mbështesë bizneset e vogla dhe të mëdha që të ketë punësime të reja, të krijojë klimë pozitive, vetëbesim tek prindërit dhe te vetë të rinjtë, se vërtet po bëhet mirë, jo t'i mbyllë sytë para skandaleve, që edhe më tepër të bëjnë të humbësh shpresën se ky vend do të bëhet ndonjëherë", thotë Ali Pajaziti profesor në Universitetin e Evropës Juglindore.

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 17 shkurt - Nga viti 2008 e deri më sot jashtë Maqedonisë jetojnë dhe punojnë më shumë se 29 për qind e personave me arsim të lartë, ndërsa në përgjithësi numri i të rinjve që çdo ditë po ikin nga Maqedonia shkon deri në 21 për qind.

Ditën e shtunë, pas shumë tentimeve për t'ia shëruar plagët e marra nga aksidenti tragjik në magjistralen Shkup-Tetovë, ndërroi jetë edhe udhëtari i 15-të nga Gostivari, 40 vjeçari Ferdi Kasim

Shkup, 17 shkurt - Rreth 25 pacientë të lënduar në tragjedinë e "Llaskarcës" vazhdojnë të mjekohen në disa spitale të vendit. Siç njoftojnë nga Ministria e Shëndetësisë, në Spitalin "8 Shtatori" në Shkup janë të hospitalizuar 18 pacientë, prej të cilëve tre janë në gjendje kritike, gjegjësisht 15 tjerë në gjendje stabile, të cilët nga ditë në ditë po shërohen.

"Në spitalet e Qendrës Klinike në Shkup janë të hospitalizuar 6 pacientë, prej të cilëve 3 në Klinikën për anestezi, reanimacion dhe mjekim intensiv. Dy nga tre pacientët që mjekohen në këtë Kli-

RIKUPERIMI RËNDË I TË LËNDUARVE TË LLASKARCËS

RREZIKU PËR JETË ENDE EKZISTON



nikë janë në gjendje stabile. Nga ana tjetër, pacienti i cili është i hospitalizuar në Klinikën për kirurgji torakale dhe pacientja shtatzanë që është e vendosur në Klinikën për gjinekologji dhe akusherë, janë po ashtu në gjendje stabile shëndetësore", thonë nga Ministria e Shëndetësisë. Mes tjerash, nga Ministria e Shëndetësisë, kanë theksuar se pacientja e cila është e shtruar në Spitalin e Tetovës është

në gjendje të mirë shëndetësore.

Ndryshe, gjatë vikendit, respektivisht ditën e shtunë, pas shumë tentimeve për t'ia shëruar plagët e marra nga aksidenti tragjik në magjistralen Shkup-Tetovë, ndërroi jetë edhe udhëtari i 15-të nga Gostivari, 40 vjeçari Ferdi Kasim. Drejtori i Qendrës emergjente kirurgjikale në Shkup, Ilir Hasani, duke shpejguar gjendjen e të ndjerit Kasim, tha se

për tre ditë radhazi ekipet mjekësore kanë tentuar ta mbajnë në jetë. Mirëpo, sipas kirurgut Hasani, gjendja e pacientit ka qenë kritike dhe nuk është përmirësuar edhe pas dy operacioneve që i janë bërë.

Me viktimin e fundit i cili ndërroi jetë të shtunë, numri i plotë i të vdekur nga aksidenti fatal në autostradën Shkup-Tetovë ka shkuar në 15 të ndjerë.

Njëkohësisht, përderisa ekipet e mjekëve po luftojnë në rikuperimin e pacientëve të "Llaskarcës", Prokuroria e Shkupit dhe institucionet përkatëse vazhdojnë me ekspertizën e autobusit të kompanisë "Durmo Turs". Paralelisht me këto hetime të Prokurorisë, Instituti për mjekësi ligjore ka kryer autopsi mbi trupat e të lënduarve, megjithatë deri më sot nuk ka të dhëna zyrtare se cilat janë arsyet e këtij aksidenti fatal.

Krahas dëshmvie nga vendngjarje, Prokuroria e Shkupit

ka paralajmëruar se nga operatorët telefonikë do të kërkoi listën e bisedave telefonike që shoferi i autobusit i realizuar ditën tragjike, gjegjësisht "Eiberr" komunikimin. Në bazë të këtyre të dhënave Prokuroria synon të vërtetojë se mos vallë shoferi i autobusit gjatë vozitjes ka qenë duke biseduar në telefon.

Ndryshe, Durmish Beluli, pronar i kompanisë së autobusave "Durmo Turs", përveçse ka deklaruar se autobusi i aksidentuar ka qenë në gjendje të mirë teknike, dhe se kjo tragjedi mund të ketë ndodhur për shkak të gjendjes shëndetësore të shoferit, ka bërë të ditur se të gjithë udhëtarët e autobusit kanë qenë të siguar. Kështu që dëshpërlimi për viktimat këtij aksidenti do të arrij vlerën e 4500 eurovë, gjegjësisht çdo i lënduar në këtë aksident pritët ta marrë dëshpërlim prej 2200 eurovë. (O.Xh)

Maqedonia si shtet humb 230 milionë euro apo 2.3 për qind të vlerës së Prodhimit të Brendshëm Bruto si rrjedhojë e fatkeqësive në rrugë, andaj kërkohet të vendosen masa sistemore, apo do të duhet të dihet se kush është përgjegjës për pikat e zeza ku më shumti kemi aksidente trafiku me pasojë vdekjeprurëse dhe kush është përgjegjës për zgjidhjen e këtij problemi

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 17 shkurt - Maqedonia vite me radhë ka shkallë të lartë të aksidenteve në trafik që përfundojnë me pasojë fatale. Maqedonia në shtatë vitet e kaluara apo përgjatë periudhës 2011-2018 ka një numër të lartë të aksidenteve në trafik që përfundojnë në mënyrë tragjike si shoferë, bashkudhëtarë dhe këmbësorë. Në vitin 2011 ka pasur 172 viktima, në vitin 2012 ka pasur 132 viktima, në vitin 2013 - 198, në vitin 2014 - 130, në vitin 2015 - 148, në vitin 2016 - 165, në vitin 2017 - 155 dhe në vitin 2018 janë shënuar 129 viktima. Në Maqedoni, vite me radhë ndërmerren aksione të ndryshme parandaluese, fushata për zvogëlimin e kësaj dukurie negative nga organe të ndryshme si MPB, Këshillit Republikan për Siguri në Komunikacionin e Rrugëve si organ konsulent e kështu me radhë, por megjithatë - akoma është shumë i lartë numri i viktimave në trafik, bile edhe në raport me mesataren evropiane. Thënë ndryshe, analizat tregojnë se në shtetet e Bashkimit Evropian ka 5.2 viktima në trafik në 100 mijë banorë, ndërsa në Maqedoni ka 7.1 viktima në 100 mijë banorë.

Nga trupi që është organ këshillëdhënës i Parlamentit të Maqedonisë, ndërsa anëtarët e tij i zgjedh organi më i lartë legjislativ në shtet - KRSKRr, thonë se në Maqedoni në vitet e kaluara në vazhdimësi ndërmerren aktivitete të shumta për të zvogëluar numrin e viktimave në trafik dhe për të rritur maksimalisht nivelin e sigurisë në komunikacion, megjithatë nga atje shtojnë se rezultatet e arritura në këtë drejtim lënë akoma për të dëshiruar. Sipas të dhënave të Këshillit Republikan për Siguri në Komunikacionin e Rrugëve, në vitin 2018, në Maqedoni kanë ndodhur 4534 fatkeqësi të trafikut të karakterit më të rëndë, me ç'rast 129 persona kanë humbur jetën në fatkeqësi të trafikut, ndërsa janë lënduar 6378 persona.

"Shikuar nga aspekti i numrit të personave që kanë vdekur në ak-

PARANDALIMI I FATKEQËSIVE NË KOMUNIKACION

SIGURIA NËPËR RRUGË, LARG MESATARES EVROPIANE



RISTO MANÇEV

Shikuar nga aspekti i numrit të personave që kanë vdekur në aksidentet e trafikut vitin e kaluar, mund të konstatohet se siguria e komunikacionit në rrugët e Maqedonisë shënon trend të përmirësimit, por njëherazi të dhënat statistikore konfirmojnë se siguria në komunikacionin rrugor nuk është në nivelin e duhur dhe nuk është në pajtueshmëri as me qëllimet dhe dinamikën e definuar në Strategjinë e dytë kombëtare të Republikës së Maqedonisë për avancimin e sigurisë në trafik 2015-2020

sidentet e trafikut vitin e kaluar, mund të konstatohet se siguria e komunikacionit në rrugët e Maqedonisë shënon trend të përmirësimit, por njëherazi të dhënat statistikore konfirmojnë se siguria në komunikacionin rrugor nuk është në nivelin e duhur dhe nuk është në pajtueshmëri as me qëllimet dhe dinamikën e definuar në Strategjinë e dytë kombëtare të Republikës së Maqedonisë për avancimin e sigurisë në trafik 2015-2020", thotë në një prononcim për gazetën KOHA, sekretari i këtij trupi, Risto Mançev.

Sipas tij, pikërisht konform qëllimeve të Strategjisë nacionale, apo sigurisë së trafikut në Republikën e Maqedonisë, deri në vitin 2020 duhet të arrihet niveli dhe

mesatarja e shteteve anëtarë të BE-së, ose kjo në shifra absolute nënkupton më pak se 100 persona të vdekur nga aksidentet e trafikut në nivel vjetor.

"Për realizimin e qëllimeve të Strategjisë, apo qëllimeve për më pak se 100 viktima në aksidentet e trafikut në nivel vjetor, është e domosdoshme që në periudhën e ardhshme, të gjitha institucionet kompetente, organet dhe organizatat, dhe të gjithë individët që në çfarëdo mënyre marrin pjesë në komunikacion, të kenë sigurinë e trafikut si përgjegjësi e përbashkët dhe prioritet të lartë shoqëror, si dhe qëllim më të lartë të përbashkët", shton më tej Mançev.

Në praktikë, kjo nënkupton, siç thotë ai, përfundimin e veprimtari-

randalues në komunikacion për të gjithë pjesëmarrësit në trafik dhe për të gjithë faktorët e rrezikut që rrezikojnë sigurinë në komunikacionin rrugor, përfundimin e edukimit të trafikut në kuadër të procesit arsimor, përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe të komunikacionit, avancimin e procesit të edukimit dhe trajnimit të kandidatëve për vozitës, avancimin e punës së autoshkollave dhe qendrave për provime, përmirësimin e sistemit për intervenime të shpejta dhe efikase pas fatkeqësive të trafikut, përfundimin e kontrolleve të policisë së komunikacionit dhe shumë masa të tjera.

Në ndërkohë, nga Ministria e Transportit në vitin e kaluar kanë paralajmëruar se do të formojnë Agjenci të re me buxhet vetanak dhe të punësuar, që për qëllim kryesor do të ketë përmirësimin e sigurisë në trafik. Agjencia që pritet të formohet brenda këtij viti, do të mbajë llogari se sa është e sigurt infrastruktura, kush i kontrollon veturat dhe sa janë ato të sigurt të lëshohen në komunikacion, bile pritet të kërkojë nga policia edhe kontrolle të përfunduara në pikat e zeza të zhvillimit të komunikacionit. Për-

vojat evropiane tregojnë se shtete që kanë formuar Agjenci të tilla kanë zvogëluar për një të tretën numrin e viktimave në aksidentet e trafikut në një afat prej 15 vitesh. Agjencia e re do të mbulojë të gjithë aspektet e problematikës që tani trajtohet nga më shumë institucione si MPB, Agjencia shtetërore e Rrugëve, Këshilli Republikan i Sigurisë në trafik etj.

Ekspertët e komunikacionit ndërkohë thonë se siguria në komunikacionin rrugor shpesh është edhe pasqyrë e sistemit shoqëror në një shtet, por edhe kulturës së mirësjelljes së të gjithë pjesëmarrësve në trafik. Maqedonia, në favor të rritjes së sigurisë në komunikacionin rrugor, nevojitet edhe më tej të rehabilitojë rrjetin ekzistues të rrugëve, të rrisë projektimin e rrugëve në një nivel më të lartë, të angazhohet për rritjen e vetëdijes së vozitësve, por edhe të rrisë kontrollet dhe dënimet nga organet kompetente. Në këtë drejtim, vitin e kaluar është vendosur punkt kontrolli që incizon me kamera një pjesë të autostradës Demir Kapi-Smokvicë, ndërsa sivjet pritet të mbulohen tërësisht me kamera rrugët në Korridorin 10 apo prej Kumanovës deri në Gjevgjeli.

Njëherazi, vlerësohet se Maqedonia si shtet humb 230 milionë euro apo 2.3 për qind të vlerës së Prodhimit të Brendshëm Bruto si rrjedhojë e fatkeqësive në rrugë, andaj kërkohet të vendosen masa sistemore, apo do të duhet të dihet se kush është përgjegjës për pikat e zeza ku më shumti kemi aksidente trafiku me pasojë vdekjeprurëse dhe kush është përgjegjës për zgjidhjen e këtij problemi.

MË SHUMË HARXHOJNË PËR ALKOOL DHE PROSTITUCION SESA PËR ILAÇE DHE LIBRA

Qytetarët e Maqedonisë së Veriut më shumë para harxhojnë në alkool, prostitucion dhe drogë sesa në ilaçe dhe libra, tregojnë të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave. Në periudhën prej vitit 2014 deri në vitin 2016, harxhimet për prostitucion nga amvisëritë janë rritur nga 53 milionë në 69 milionë euro, për drogë nga 32 në 39 milionë euro, ndërkaq për alkool nga 126 në 142 milionë euro. Harxhimet për ilaçe dhe aparate ndihmëse (proteza, karroca invalide) në vitin 2014-të kanë

arritur në 36 milionë euro, ndërkaq dy vite më vonë kanë qenë 41 milionë euro. Harxhimet për libra, revista dhe gazeta në këtë periudhë trevjeçare kanë ngelur të çimentuara në 11 milionë euro. Të dhënat e këtyre tregojnë se prostitucioni dhe shitja e drogës gjenerojnë profite nga miliona euro për strukturat e caktuara kriminale, ndërkaq shteti për atë nuk sheh asnjë denarë pasi që bëhet fjalë për biznes ilegal, i cili nuk ka tatime.

“Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit do ta ndjekë tërë procesin zgjedhor edhe në raste të bazave të dyshimit se shkelet ligji do të ndërmarrë masa për konfirmim të dyshimeve të tilla, do t'i njoftojë organet kompetente dhe do të kërkojë ndërmarrje të aktiviteteve në suaza të veprimit të tyre kompetent...”, thuhet në njoftimin e Antikorrupsionit

KSHPK ME APEL DREJTUAR FUNKSIONARËVE SHTETËROR

RESPEKTOJENI LIGJIN



muara në nenet 34 dhe 35 të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe ndeshjes së interesave edhe në nenet 8-të dhe 8-b të Kodit zgjedhor, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit do t'i llogarisë si përgjegjësi të personave përgjegjës në organet shtetërore dhe subjektet tjera, ndërsa në rast të shkeljeve të konstatuara dhe keqpërdorimeve do të ndërmarrë aktivitete adekuata dhe masa sipas ligjit”, thonë nga Komisioni Antikorrupsionit.

Në periudhën e ardhshme të zbatimit të aktiviteteve me zgjedhjet presidenciale, si dhe zgjedhjet e caktuara të parakohshme për kryetar të komunës së Ohrit, kryetar të komunës Novo Sello dhe kryetar të komunës së Dibrës, KSHPK sipas dispozitave të Ligjit të ri për parandalim të korrupsionit dhe ndeshjes së interesave nuk ka bazë ligjore të japë mendim për kërkesat e dorëzuara për mendime të lidhura me mënyrën e veprimit të ministrive, njësitve të vetëqeverisjes lokale, fondeve, agjencive, drejtorive, ndërmarrjeve publike, trupave rregullator, shoqatave tregtare të themeluara nga shteti dhe institucione tjera të themeluara nga shteti gjatë procesit zgjedhor. Në seancën e parë Komisioni ka apeluar që funksionarët, në nivel shtetëror ose lokal, të mos kërkojnë mendim për atë nëse mund ta bëjnë një aktivitet të caktuar apo jo. Nga Komisioni Antikorrupsionit thonë se nuk janë kompetent të japin mendim të tillë, ndërsa Ligji për ndalim të korrupsionit është mjaft i qartë, dhe duhet të zbatohet deri në fund.

Koha Qefser ABDYLI

Shkup, 17 shkurt - Në periudhën e sjelljes së vendimit për shpallje të zgjedhjeve presidenciale nuk guxon të fillohet çfarëdo lloj ndërtimi me mjete të buxhetit ose të fondeve publike ose me mjete të ndërmarrjeve publike dhe persona tjerë juridik që disponojnë me kapital shtetëror nuk mund të bëjnë pagesa të pagave, pensioneve, ndihmës sociale ose pagesa tjera dhe kompensime materiale nga mjetet buxhetore ose nga mjetet e fondeve publike që nuk janë pagesa të rregullta mujore, ndërsa nuk mund të fillojë as procedura për punësim të personave të rinj ose procedura për ndërprerje të marrëdhënies së punës në institucionet shtetërore dhe publike, informon Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit.

Nga Komisioni sqarojnë se nuk mund të fillojë ndërtimi me mjete të buxhetit ose nga fondet publike ose me mjete të ndërmarrjeve publike ose persona tjerë juridik që disponojnë me kapital shtetëror të objekteve të reja në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, kanalizim, kënde sportive, linja të energjisë dhe

objekte tjera ose objekte për veprimtari shoqërore shkolla, kopshete dhe objekte tjera, përveç nëse për atë qëllim paraprakisht sigurohen mjete nga buxheti, përkatësisht bëhet fjalë për realizimin e programit të sjellur në bazë të ligjit për vitin rrjedhës. Nuk mund të bëhen pagesa të pagave, pensione, ndihmës sociale ose pagesa tjera dhe kompensime të materialeve nga mjetet buxhetore ose nga mjetet e fondeve publike që nuk janë pagesa të rregullta mujore, përkatësisht të gjitha transferet njëvjeçare dhe pagesat ose transfere të njëhershme nga mjetet buxhetore ose nga mjetet e fondeve publike pa u tjetërsuar kapitali shtetëror pa u nënshkruar marrëveshje kolektive, ndërsa nuk mund të fillohet procedurë për punësim të personave të rinj ose procedurë për ndërprerje të marrëdhënies së punës në institucionet shtetërore dhe publike. Procedurat e filluara duhet të lihen në

gatishmëri, përveç në raste të punëve urgjente dhe të pa anuluar.

Në periudhën prej 20 ditësh para fillimit të fushatës zgjedhore, deri në përfundimin e zgjedhjes së presidentit dhe deri në përfundimin e zgjedhjeve për zgjedhje të kryetarit të komunës, nuk mund të mbahen ngjarje publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objekteve me mjete nga Buxheti ose nga fondet publike, ose me mjete të ndërmarrjeve publike ose persona tjerë juridik që disponojnë me kapital shtetëror, në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, kanalizim, linja të energjisë, kënde sportive dhe objekte tjera ose objekte për veprimtari shoqërore, shkolla, kopshete dhe objekte tjera. Nën ndalesë të mbajtjes së ngjarjeve publike, thonë nga KSHPK, nuk nënkuptohet dhënie e veçantë e deklaratës publike të bartësve të funksionit publik ose kandidat për

bartës të funksionit publik në tubime, intervistë për mediumet, debat në medime ose përgjigje e pyetjes së gazetarëve.

Për nevojat e fushatës zgjedhore, ndalohet shfrytëzimi i hapësirës së zyrave, pajisjes së zyrave dhe automjeteve zyrtare të organeve shtetërore, me përjashtim të personave për të cilët zbatohen dispozitat e veçanta për mbrojtje të personalitetit. Ndalohet edhe kryerja dhe përpjekja për kryerje të presionit dhe frikësim të votuesve ose anëtarëve të familjeve të tyre ose personave të tyre të afërt.

“Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit do ta ndjekë tërë procesin zgjedhor edhe në raste të bazave të dyshimit se shkelet ligji do të ndërmarrë masa për konfirmim të dyshimeve të tilla, do t'i njoftojë organet kompetente dhe do të kërkojë ndërmarrje të aktiviteteve në suaza të veprimit të tyre kompetent. Mospespektimi i ndalesave të konfir-

HYN NË FUQI LIGJI PËR PËRMBARIM

U JEPET FUND TAKSAVE TË LARTA NGA PËRMBARUESIT

Shkup, 17 shkurt - Dy muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për përmbarduesit, në përdorim hyri edhe tarifa e re e përmbardimit, e cila për disa pagesa është disa herë më e vogël se e mëparshmeja, ndërsa për të tjerat mbetet pothuajse e njëjtë. Por, siç shpjegon kryetari i Odës së Përmbarduesve të Maqedonisë, Zoran Dimov, ajo nuk vlen në mënyrë retroaktive, por vetëm për urdhrat e ri, nga e premtja kur hyri në fuqi, e më tej. Ashtu, te pagesa e detyrueshme të borxheve të qytetarëve nga rroga përmes firmës ose nga llogaria transakcionale në bankë, përmbarduesit tani marrin dy euro, ndërsa me tarifën e mëparshme - shpërblimi ishte 20 euro. Por, debitorët edhe më tej vet do t'iu paguajnë bankave për bl-

lokim dhe zhbllokim të llogarisë, përveç në rastet kur bëhet fjalë për bllokimin e llogarive prej të cilave nuk lejohet përmbardimi, siç janë personat që pranojnë ndihma sociale.

Me urdhrat e ri për pagesë të detyruar të llogarive për rrymë, nxehe, operatorë kabllorë, telefon, mirëmbajtje të hapësirave të përbashkëta në ndërtesë, të cilat janë në shumën deri më 100 euro, përmbarduesit marrin 2, në vend të 14.5 eurove të deritanishme siç ishte me tarifën e mëparshme. Për borxhet prej 100 deri 200 euro tani shpërblimi është 5 euro, ndërsa për shumat mbi 200 euro është 10, për dallim të mbi 20 eurove të mëparshme.

Te dokumentet përmbardimo-

re për vendime gjyqësore dhe zgjidhjet e shërbimeve dhe ndërmarrjeve shtetërore paguhet 6.5 euro nëse borxhi themelor është deri në 100 euro, ndërsa nëse shuma e borxhit është prej 100 deri 300 euro, atëherë tarifa përmbardimore është 10.5 euro. Kur realizohen shumat më të larta, atëherë kompensimet për përmbardues me tarifën e re mbesin poshtë-lart të njëjta me atë të vjetrën. Për kërkesat deri në 3000 euro, tani shpërblimi është 7.5 për qind nga borxhi themelor, përdërisa më parë ishte 8 për qind plus 30 euro për administrim. Njëkohësisht, me tarifën e përmbarduesve, në fuqi hyri edhe tarifa e re e noterëve, e cila ka të bëjë me ekzekutimin e borxhit. Sipas tarifës së re, shpërblimi i noterit



për lëndët e tilla nuk mund të jetë më i lartë se 500 denarë. Kjo ka të bëjë edhe me borxhet mbi 1000 euro, për të cilat sipas mënyrës së vjetër paguheshin 35 euro.

Kjo duhet të jetë një lehtësim i madh për qytetarët, të cilët deri

tani për borxh prej 200 denarësh shpesh kanë paguar edhe më shumë se 200 euro. Por, interesat e borxheve të vjetër edhe më tej mbesin të larta, ndërsa këtu janë edhe tarifata e avokatit jo aq të vogla. (Q.A)

PËRKUJTOHET SAKRIFICA E BANORËVE TË REÇICËS DHE POROJIT

UT SHËNON 24 VJETORIN E LIGJËRATAVE TË PARA

“Mbajtja e ligjëratave të para ishte me përplot sfida, sepse fshati dhe objekti ku do të mbaheshin ligjëratat e para, ishte i rrethuar me forca policore, por në mbrojtje të profesorëve dhe studentëve të parë, doli popullata vendase e këtij fshati dhe nga rrethina e Tetovës”, tha një nga studentët e parë atëkohë, tashmë prof.dr Jusuf Zendeli



universiteti tashmë i ndjeri Fadil Sulejmani.

Në ndërkohë, rektori i Universitetit të Tetovës, Vullnet Ameti së bashku me profesorët, prorektorët, dekanët... vizituan edhe fshatin Poroj. Në mejtepin e këtij fshati u mbajtën ligjëratat e para më 17 shkurt të vitit 1995. Të pranishmit u njohën edhe me historikun e ngjarjeve të asaj kohe në këtë objekt, i cili tashmë është muze me shumë faktografi dhe dëshmi të asaj kohe.

Sipas prorektorit të UT-së, Arbër Çeliku, kjo datë është shumë e rëndësishme për mbarë shqiptarët, sepse përkon edhe me shpalljen e Pavarësisë së shtetit të

Kosovës. “Si popullatë shqiptare në këto treva, kemi fatin të shënojmë dy ngjarje të rëndësishme. E para është 17 shkurti i fillimit të ligjëratave të para në vitin 1995 që shënon një kthesë tek popullata shqiptare në Maqedoni. Universiteti i Tetovës më pas e dëshmoi me punën e tij, sepse kemi krijuar 24 vjet Universitet, i kemi dhënë kuadro këtij shteti, të cilët i udhëheqin proceset në këtë shtet. E dyta është se më 17 shkurt të vitit 2008, në Ballkan u krijua shteti i dytë që do të ndikojë në relaksim dhe situatave të përgjithshme, politike, shoqërore dhe ekonomike”, tha Çeliku.

“Mbajtja e ligjëratave të para

ishte me përplot sfida, sepse fshati dhe objekti ku do të mbaheshin ligjëratat e para ishte i rrethuar me forca policore, por në mbrojtje të profesorëve dhe studentëve të parë doli popullata vendase e këtij fshati dhe nga rrethina e Tetovës”, tha një nga studentët e parë, tashmë profesor doktor Jusuf Zendeli, nga fshati Poroj.

“Fillimi i ligjëratave të para janë ndër ngjarjet më të rëndësishme të shqiptarëve të Maqedonisë. Pas aktit të themelimit të Universitetit, mbajtja e ligjëratave të para nuk ka qenë e lehtë, ka qenë një proces shumë i vështirë, i përcjellë me shumë sfida, por falë banorëve të Reçicës, Porojit dhe gjithë shqip-

tarëve gjithandej që sakrifkuan gjithçka, studentët e parë, profesorët e parë, sidomos nga Universiteti i Prishtinës dhe u arrit të mbahen ligjëratat e para. Kjo ishte një dëshmi se shqiptarët e duan arsimin, shkollimin dhe natyrisht kjo mundësoi që pas disa viteve, ky institucion të zyrtarizohet”, tha Zendeli.

Sipas tij, Universiteti i Tetovës më pas me krijimin e kuadrove, arriti të kthejë tërë sakrificën për këta banorë, sepse këta kuadro tashmë janë në shërbim të asaj popullate që dikur i mbrojti. “Për ne është mburrje dhe krenari që kemi sakrifkuar bashkë për të krijuar një universitet prestigjioz, një universitet që tashmë ka bashkëpunim me shumë universitete nga mbarë bota, sidomos nga SHBA-të. Për të gjitha ata vuajtje, vështirësi dhe sakrificë, unë mund të them se ja ka vlejtur sepse ne dëshmuam se jemi për t'u shkolluar dhe të kontribuojnë shumë në këtë shtet”, tha më tej Zendeli. Më 17 shkurt të vitit 1995 filluan ligjëratat e para, të cilat u mbajtën në fshatin Poroj dhe në Reçicë të Vogël, atje ku ishin tubuar mijëra njerëz për të mbështetur studentët dhe profesorët.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 17 shkurt – Njëzet e katër vjetori i fillimit të ligjëratave të para në Universitetin e Tetovës të dielën është shënuar me disa aktivitete nga ana e stafit drejtues të Universitetit të Tetovës. Fillimisht janë bërë homazhe pranë bustit të dëshmorit të arsimit Abdylselam Emini, në Reçicë të Vogël, ndërsa më pas drejtuesit e Universitetit të Tetovës kanë bërë homazhe edhe tek varri i rektorit të parë të këtij

Prezantohet Plani Gjeneral për Tetovën

Tetovë, 17 shkurt - Komuna e Tetovës ka organizuar debat publik për prezantimin e procesit të përgatitjes së Programit planor për përpunimin e Planit Gjeneral Urbanistik të qytetit të Tetovës për periudhën 2019-2029. Grupi i punës që kanë marrë përsipër përpilimin e Planit përpara qytetarëve kanë prezantuar detaje të aspekteve programore të planit gjeneral urbanistik, ku sipas planifikimeve të reja, parashihen sa më shumë hapësira të gjelbërta, vendparkime, përfundimin e bulevardëve Iliria, Bllagoja Toska dhe Video Smilevski Bato, si dhe parashihet zgjerim të zonave urbanistike duke marrë parasysh se Tetova është qytet i dy

Universiteteve dhe ka më shumë nevojë për këtë. Fillimisht, arkitektja Bushra Zejneli nga Komuna e Tetovës prezantoi shkallën e realizimit të Planit Gjeneral Urbanistik aktual të Tetovës, sfidat dhe praktikën më të mira ku plani i vitit 2003-2013 u vlerësua si një plan kaotik. Eksperti ndërkombëtar për zvogëlimin e rrezikut nga gjendjet katastrofike dhe zhvillim të qëndrueshëm urban, Majk Sheroks, në përpilimin e Planit të ri do të punojë në infrastrukturën e pengimit të rreziqeve në rast të vërshimeve eventuale që viteve të fundit disa herë goditën qytetin me rrethinë duke i shkaktuar dëme materiale dhe viktima në njerëz. (U.H)

Publicitet

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 të Rregullores për mënyrën dhe realizimin e ekskursioneve shkollore dhe aktiviteteve të tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore nr. 07-2250/1 të datës 05.06.2014 nga MASH, SHF “Hasan Prishtina” Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE
për grumbullim të ofertave

SHF “Hasan Prishtina”, rr. Kosta Abrasheviq nr. 7 – Shkup, organizon ekskursione dhe aktivitete të tjera të lira për nxënësit në vitin shkollor 2018/2019 në pajtim me Programin për aktivitetet e theksuara:

- Shëtitje njëditore për nxënësit e klasës I-IX **Shkup Sara**
- Ekskursion njëditor për nxënësit e klasës së III **Shkup-Kavadar-Stobi-Feni-Hee Tikvesh-Shkup**
- Ekskursion dyditor për nxënësit e klasës së VI **Shkup-Pehçevë-Berovë-Strumicë-Dojran-Negotinë-Kavadar-Shkup**
- Ekskursion treditor për nxënësit e klasës së IX **Shkup-Heraklea-Manastir-Ohër-Strugë-Vevçani-Dibër-Tetovë-Shkup**
- Mësim në natyrë për nxënësit e klasës së V – **Shkup-Strugë-Shkup**

Kushtet minimale të cilat duhet ti përmbushë ofertuesi janë:

- të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike.
- të ketë të realizuar në mënyrë të suksesshme së paku 3 ekskursione për nxënësit dhe aktivitete të tjera të lira në 3 vitet e fundit.
- të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.

Oferta e ofertuesit i cili nuk plotëson kushtet minimale do të refuzohet nga ana e Komisionit si e papranueshme.

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen ofertuesi:

- Dokument nga Regjistri qendror për regjistrim të veprimtarisë – DRD formulari, licencë për kryerje të veprimtarisë turistike,
- kopje të marrëveshjes dhe vërtetim për realizim të suksesshëm të së paku tre ekskursioneve shkollore dhe aktiviteteve të tjera të lira, në tre vitet e fundit për secilin ekskursion të realizuar veç e veç.
- Deklaratë se plotëson kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet
- Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes ofertuesi i zgjedhur dorëzon garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursionit dhe aktiviteteve të tjera të lira në shumë prej 5% nga vlera e përgjithshme e marrëveshjes.

Ftohen ofertuesit e interesuar të dorëzojnë oferta sipas dokumentacionit që mund të merret në shkollë deri më 22.02.2019 çdo ditë pune prej ora 8,00-14,00 tek sekretari i shkollës.

Tel për kontakt 2621-055

e-mail shf.hasanprishtina@yahoo.com

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 34/2014, 113/2014) dhe nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014 dhe 135/2014) dhe vendimit nr. 04-374/1, u. d Drejtori i SHFK “Kirili dhe Metodij” f. Oraovicë publikon

SHPALLJE

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për kohë të caktuar për vitin shkollor 2018/2019 deri më 31.08.2019

1. Mësimdhënës të Historisë – 1 realizues – 8 orë mësimore, pagesa bazë 8.000,00 denarë,
2. Mësimdhënës të Arsimit muzikor – 1 realizues – 7 orë mësimore, pagesa bazë 7.000,00 denarë,

Orari i punës së mësimdhënësve është prej ditës së hënë deri ditën e premte, në një ndërrim, gjegjësisht fillon në ora 07:00 ndërsa përfundon në ora 13:00, ndërsa në pajtim me orarin dhe numrin e orëve mësimore.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara në LMP, si dhe kushtet e posaçme të caktuara me nenin 80 në Ligjin për arsim fillor, si dhe kushtet e parapara në Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës.

Kandidatët të cilët do të paraqiten në lidhje me shpalljen për vendet e punës së bashku me lutjen duhet të dorëzojnë edhe dokumentet në vijim: Diplomë ose Certifikatë për arsimin e mbaruar (fotokopje të vërtetuar në noter ose original), Certifikatë të shtetësisë, Certifikatë për provim të dhënë profesional (nëse e posedojnë).

Shpallja zgjatet 5 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në SHFK “Kirili dhe Metodij” f. Oraovicë.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara në lidhje me shpalljen e publikuar nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Zgjedhja do të bëhet brenda 30 ditëve.

Telefoni për kontakt: 032 641-005

SHFK “Kirili dhe Metodij” f. Oraovicë

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune –tekst i spastruar (“Gazeta zyrtare e RM” nr.167/2015) dhe neni 77, 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (“Gazeta zyrtare e RM” nr.103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14,10/15,98/15 145/15,30/16, 127/2016 dhe 67/2017) dhe pëlqimi i marrë nga Ministria e arsimit dhe shkencës nr.12-569/2 të datës 23.01.2019 dhe pëlqimi me nr. 12-877/3 të datës 07.02.2019, Drejtori i shkollës fillore komunale “Përparimi” f. Reçicë e Madhe, Tetovë, publikon këtë:

SH P A L L J E

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të caktuar deri më 31.08.2019

MËSIMI ZHVILLOHET NË GJUHËN SHQIPE për vitin shkollor 2018/19

1. Një bashkëpunëtor profesional-psikolog me fond 40 orë në javë, orari i punës para dite prej ora 08⁰⁰ deri 16⁰⁰ të hënës deri të premten, me neto rrogë 21.661,00 denarë, **shkollim i kryer –psikolog i diplomuar me arsim të lartë adekuat 240 kredi, shkalla VIII**
2. Një arsimtar për arsim fizik e shëndetësor me fond 20 orë mësimore në javë, orari i punës para dite prej ora 07⁰⁰ deri 13⁰⁰ të hënës deri të premten, me neto rrogë 21.661,00 denarë, **shkollim i kryer studimet e përfunduara fakultet të kryer për kulturë fizike - drejtimi arsimor.**

KUSHTET :

Krahas kushteve të përgjithshme sipas Ligjit për marrëdhënie pune kandidati duhet ti plotësojë edhe kushtet e parapara nga Ligji për arsim fillor.

Kandidatët duhet të dorëzojnë: Lutje për themelimin të marrëdhënies së punës; diplomë për arsimin e kryer; certifikatë e shtetësisë; vërtetim se nuk janë nën hetime dhe të gjykuar; certifikatën e lindje; certifikatë mjekësore. Dokumentet të dorëzohen në formë origjinale ose te noterizuar.

Konkursi mbetet i hapur 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në mjetet e shkruara të informimit, zgjedhja do të bëhet në afat prej 15 ditësh nga dita e mbylljes së të shpalljes.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen pranë shkollës fillore komunale “Përparimi” në fsh. Reçicë e Madhe, Tetovë, telefon 044/481-352.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dërguara jashtë afatit, nuk do të shqyrtohen.

SH.F.K “Përparimi” Reçicë e Madhe, Tetovë

Në Konferencën e Sigurisë në Mynih paraqitën pikëpamjet e tyre kancelarja, Angela Merkel dhe zëvendës-presidenti amerikan, Mike Pence. Mikja e multilateralizmit, Merkel përballtet me mbrojtësin e superfuqisë botërore

MERKEL DHE MIKE PENCE KUR DY BOTË PËRPLASEN

Ata e shohin nga këndvështrimet e ndryshme botën: Kancelarja gjermane, Angela Merkel dhe zëvendës-presidenti amerikan, Mike Pence. Presidenti amerikan, Donald Trump nuk ishte pjesë e kësaj konference të rëndësishme që trajton problemet e sigurisë globale, duke theksuar kështu qëndrimin e tij "America First". Ndërsa Merkel kërkon të shpëtojë multilateralizmin, që e përcakton botën nga fundi i Luftës së Dytë Botërore e të cilin për ironi e nxitën vetë Shtetet e Bashkuara. A është rastësi që njoftimi i fundit për grindjen tregtare me SHBA del pikërisht gjatë kësaj konference në pah? Merkel mund të përmendte një shembull të freskët për largimin e SHBA nga bashkëpunimi me partnerët: Ministria e Tregtisë në SHBA me sa duket ka arritur në përfundimin, se automjetet nga Gjermania janë një kërcënim për SHBA. Mbi këtë bazë presidenti Trump mund të ngrejë dogana të reja. Merkel e ironizoi hapur këtë. Shumë automjete prodhohen në filiale të koncerneve gjermane në SHBA: "Nëse këto automjete që prodhohen në South Carolina janë papritur një kërcënim për sigurinë kombëtare të SHBA, atëherë kjo na shokon", tha Merkel.



MERKEL: MOS I SHKATËRRONI STRUKTURAT

Megjithë ironinë, Merkel mbajti një fjalim mjaft serioz. Tingëlloi si amaneti i saj. Ajo preku të gjitha temat e mëdha botërore, nga tregtia botërore tek migrimi, nga Rusia tek Kina e Irani. Mesazhi i saj vendimtar: "Strukturat janë nën presion të madh", por ne "nuk duhet thjesht t'i shkatërrojmë". Ajo nuk e tha hapur, por pikërisht për këtë ajo e akuzoi presidentin Trump.

Mesazhi i dytë i Merkel: Duhet të mbetemi në dialog, edhe me partnerë të vështirë. Kjo vlen sidomos për Rusinë. Nga pikëpamja gjeostrategjike, Europa megjithë vështirësitë që ka me Rusinë "nuk

ka interes të prishë të gjitha marrëdhëniet me Moskën". Në këtë kontekst Merkel shprehu mbështetjen edhe njëherë për gazsjellësin e kontestuar, Nord Stream 2, përmes të cilit vjen direkt gaz nga Gjermania në Rusi.

PENCE: TRUMP E KA BËRË SHBA SËRISH TË FORTË

Por për Mike Pence pikërisht ky projekt do të thotë varësi e rrezikshme nga Rusia. "Ne nuk mund të garantojmë mbrojtjen e perëndimit, kur partnerët tanë të aleancës bëhen të varur nga lindja", tha Pence. Ndryshe nga Merkel që pranoi edhe probleme e në tërësi u shfaq përmbajtur, zëvendës-presidenti

amerikan, mbajti një fjalim plot lëvdata për presidentin Trump dhe arrijtet e qeverisë së tij. Ai u përqendrua tek rikthimi i fuqisë së SHBA nën presidentin Trump dhe lufta për liri. Sipas Pence, Trump është keqkuptuar shumë. Ai nuk dëshiron t'u kthejë kurrizin partnerëve. Por "nëse jemi të fortë dhe në ujdi, nuk ka asgjë që nuk mund ta arrijmë". Trump dhe Mike Pence e kanë të qartë se ç'duhet të bëjnë partnerët: Më shumë shpenzime për mbrojtjen, sidomos Gjermania. Të dorëzohet projekti Nord Stream 2 dhe në vend të kësaj të blihet gaz i lëngshëm amerikan. Kthesë kundër Iranit, dalje nga marrëveshja atomike, sepse "Irani është "nxitësi më i

madh i terrorizmit shtetëror në botë" dhe dëshiron një Holocaust të ri. Dhe të mbështetet kreu i opozitës venezuelane e të njihet si president i përkoshëm i vendit Juan Guaido.

MERKELI ME VETËBESIM

Merkel dhe Pence folën kanë qëndrime të ndryshme e vështrimi i tyre mbi botën lidhet shumë me vetë shtetet nga ata vijnë - kancelarja gjermane, kreu i qeverisë së një fuqie të mesme civile, që është e interesuar për balancimin e interesave - nga ana tjetër përfaqësuesi nr 2 i një superfuqie ushtarake dhe politike, që përpiqet të mbrojë pozicionin e saj kundër rivalëve të vjetër si Rusia apo superfuqive në rritje si Kina. Dhe që është mësuar, që si superfuqi të dëgjohet. Por Merkel është politikane me vetëbesim ndërkohë. Si fjalë përfundimtare ajo citoi republikanin, Lindsey Graham, që nuk pati shans kundër Trumpit në kandidaturat e brendshme partiake. Graham ka përcaktuar moton tha Merkel: "Multilateralizmi mund të jetë i vështirë, por ai është më i mirë se të jesh i vetëm në shtëpi". E si Pence e Trump nuk do t'i ketë pëlqyer që kancelarja gjermane si mbrojtës të multilateralizmit merr pikërisht një politikan nga Partia Republikane e Trumpit. (DW)



15 të arrestuar për protestën e Tiranës

Policia e Tiranës ka arrestuar 15 persona të cilët akuzohen për aktet e dhunës në protestën e ditës së shtunë përpara Kryeministrit. Zyrtarisht, Drejtoria e Policisë Tiranë njofton se mbi të arrestuarit rëndojnë akuzat e "kundërshtimit të punonjësit të policisë", "goditje për shkak të detyrës", "shkatërrim prone" dhe "prishje e rendit dhe qetësisë publike". Në mesin e 15 personave të arrestuar është edhe Florenc Hoxha, ish-drejtor i Policisë Bashkiake të Tiranës në

kohën kur bashkinë e kryeqytetit e drejtonte Lulzim Basha. Florenc Hoxha u shoqërua mbrëmjen e së shtunës në Drejtorinë e Policisë Tiranë si person i dyshuar për nxitje të akteve të dhunës. Të dyshuarit u vunë në pranga pas analizimit të filmimeve të bëra në terren nga efektivet e policisë dhe të Gardës. Gjithashtu, në kuadër të këtyre hetimeve janë proceduar në gjendje të lirë 5 persona, ndërsa 7 të tjerë janë shpallur në kërkim.

SHBA-të nuk heqin dorë nga përgjegjësia për vëllezërit Bytyçi

Delegacioni i Kongresit amerikan në të cilin ka qenë edhe Eliot Engel, në Mynih ka zhvilluar një bisedë me presidentin e Serbisë Aleksandar Vuçiq. "Ka qenë një bisedë tepër e vështirë. Për palën amerikane më i rëndësishëm ka qenë rasti i vrasjes së vëllezërve Bytyçi dhe zgjidhja e tij e pastaj Kosova", citon gazeta "Blic" e Beogradit të ketë thënë një burim i saj nga takimi.

Rasti i vëllezërve Bytyçi është problemi kryesor që i rëndon marrëdhëniet SHBA-Serbi tash e dy decenie. Pas ardhjes së administratës së Trumpit, ky rast kishte rënë në plan të dytë dhe dukej se dialogu Serbi-Kosovë dhe arritja e marrëveshjes ndërmjet dy palëve ishte bërë temë dominuese. Por biseda e djeshme zhvilluar në Mynih, e ka përgjeshtruar këtë, konstaton gazeta serbe, transmeton Koha.net. Vëllezërit Bytyçi, Yll,



Mehmet dhe Agron, shtetas amerikanë të lindur në Kosovë, gjatë luftës iu bashkuan UÇK-së, ndërsa në korrikun e vitit 1999 u vranë me plumb në qafë në territorin Serbisë.

Prej atëherë e deri më tash, të gjitha administratat amerikane kanë kërkuar përgjigje në pyetjet kush i ka vranë dhe kush ka qenë në zinxhirin komandues. Në Rezo-

lutën e Senatit të vitit 2017 përmenden tre zyrtarë serbë, ish-ministri i atëhershëm i Punëve të Brendshme Vljako Stojilković i cili bëri vetëvrasje në vitin 2002, ish-shëf i sigurisë publike në MPB të Serbisë Vlastimir Gjorgjević i cili në Hagë u dënua me 18 vjet burgim si dhe ish-komandanti i njësi-ve speciale policore në Kosovë Goran Radosavljević - Guri.

Brukseli e "hodhi në erë" BREXIT-in

Nga
Bruno MAÇAES



Brexit, i parë nga Evropa, duket si për shumë njerëz një rrëmujë veçanërisht britanike. Por, sikur rrëmujaxhinjtë të jemi ne? Është një ide jo shumë popullore në këtë anë të Kanalit. Por ngërçi ku ka hyrë Brexit, nuk është një faji i kryeministres britanik Tereza Mej. Përkundrazi, është vetë procesi i negociimit, ai që krijoi kushtet për këtë dështim - dhe faji për këtë, është para së gjithash i Brukselit. Bisedimet e Brexit ishin të keq-përgatitura që nga fillimi - diçka që ndodh shpesh, kur ua ngarkon këtë detyrë burokratëve.

BE-ja refuzoi të diskutonte natyrën e marrëdhënieve të saj të ardhshme me Britaninë e Madhe, nëse Londra nuk binte dakord që të mos kishte ndonjë kufizim të rëndësishëm në kufirin midis Irlandës dhe Irlandës së Veriut. Ish-te pikërisht vendimi për të përfshirë çështjen e kufirit irlandez në fazën e parë të negociatave, ai që siguroi mosbërritjen asnjëherë tek faza e dytë. Kanë kaluar 30 muaj, që kur Britania e Madhe evokoi nenin 50. Dhe ne vetëm sa kemi cekur pjesën e negociatave, që kanë të bëjnë me termat e marrëdhënieve të ardhshme - pjesë e diskutimeve, që në fund do të vendosë statusin e kufirit që ndan BE-në dhe Mbretërinë e Bashkuar. Tek e fundit, faza e parë sillte rreth 3 çështjeve mbi të cilat duhej vendosur në parim, dhe jo bazuar tek pragmatizmi. A do të na duhet një kufi i ashpër, një kufi i lehtë, apo gati asnjë kufi? Kjo varet nga marrëdhënia e ardhshme. Nëse ky proces ishte logjik, statusi i një segmenti të vogël të kufirit të BE-së me Mbretërinë e Bashkuar, sado i veçantë dhe jetik që mund të jetë, do të diskutohet gjatë bisedimeve mbi marrëdhënien gjithëpërfshirëse - ku do të përfshihen edhe çështje të mëdha si tregtia dhe siguria e jashtme.

Për nga mënyra se si është hartuar procesi - përfshirja e kufirit irlandez në mesin e 3 temave kryesore, mbi të cilat do të negociohet përpara se Britania të largohet zyrtarisht nga blloku më 29 mars - duket se që të dyja palët duhet të arrijnë një marrëveshje, mbi një çështje që efektivisht nuk u lejohej ta diskutonin. Ekzistojnë kaq shumë pikëpyetje - për shembull, cila do të jetë marrëdhënia tregtare e Mbretërisë së Bashkuar me BE-në pas Brexit? - që varen mbi çështjen e kufirit irlandez. Nuk është çudi që ajo është ende e pazgjidhur. Atëherë, pse u përfshi në fazën e parë të diskutimeve? Brukseli mendoi që për të vepruar me përgjegjësi në procesin e negociimit, britanikët duhej t'ia fillonin nga një

rezolutë e fortë për të nderuar angazhimet e tyre. Para se diskutimi të kthehej tek peshkimi, djathi dhe shërbimet bankare, Brukseli vendosi se duhej të sundonte parimi moral. Britania, vijonte arsyetimi, duhej së pari të binte dakord të paguante paratë që duhej të kontribuonte në arkën e BE-së, të siguronte të drejtat e qytetarëve të BE-së që jetonin në Britani, dhe të respektonte pritshmëritë legjitime të të gjithë nënshkruesve të Marrëveshjes së të Premtes së Mirë, që i dha fund "Trazirave" në Irlandë.

Kishte gjithashtu një arsye praktike pse Evropa donte që së pari të përqendrohej në çështjet parimore. Kjo rriste gjasat, që vendet anëtare të BE-së të qëndronin të bashkuara. Dhe kjo ka funksionuar. Përqendrimi i debatit rreth garancisë që Britania e Madhe të vepronte me mirëbesim, ndihmoi në forcimin e asaj që doli të ishte një front i bashkuar midis BE27. Megjithatë, duke pasur parasysh gjendjen e negociatave, ky mund të jetë një vendim për të cilin BE-ja mund të pendohet. Por Brukseli nuk mund ta kishte bërë këtë, pa ndihmën e kryeministres britanike. Dështimi për të rezistuar mjaftueshëm diskutimit në lidhje me çështjen e kufirit irlandez, ishte gabimi tragjik i Tereza Mej - një çështje për të cilën do të ketë kohë të mjaftueshme për t'u ulur në vitet në vijim. Heqja e pyetjes irlandeze nga faza e parë e bi-

sedimeve, do të kishte qenë edhe në interesin e vetë BE-së.

Në vend të kësaj, ajo i udhëzoi negociatorët e saj që të përçanin frontin e bashkuar të BE-së, duke u përpjekur të fusnin elementë nga faza e dytë e negociatave. Ky ishte një gabim i madh. Interesi i saj - dhe ka shumë të ngjarë edhe interesi i vendit - ishte ngadalësimi dhe jo përshpejtimi i gjërave. Mej do të përfundonte aktin e parë. Të hidhte hapat njëri pas tjetrit, duke e përfunduar Marrëveshjen e Tërheqjes në kohën e duhur - ndoshta edhe përpara afatit - dhe me prestigjin e saj të paprekur, ajo mund të kërkonte mbajtjen e zgjedhjeve të reja në vend. Duke mbajtur premtimin e saj për ta nxjerrë Britaninë nga BE-ja, askush nuk do të dyshonte qoftë edhe për një minutë, nëse ajo ishte personi i duhur për të udhëhequr Mbretërinë e Bashkuar, në një partneritet të ri me bllokun. Për këtë, kryeministria kishte nevojë vetëm për një gjë: Të hiqte çështjen irlandeze nga fushëveprimi i Marrëveshjes së Tërheqjes.

Ajo duhet të kishte investuar në atë detyrë specifike, të gjithë kapitalin e saj politik, dhe aftësitë e diplomatëve të saj të kalitur. Ky do të qe një objektivi i arritshëm. Heqja e çështjes irlandeze nga faza e parë e bisedimeve, do të kishte qenë edhe në interesat e BE-së. Pse? Sepse, pavarësisht shfaqjes së unitetit dhe këmbënguljes se

Aktualisht, ekziston një rrezik shumë i madh, që klubi në fakt të përbëhet nga 27 anëtarë e gjysmë. Përgjithmonë. Unioni mund të rezistojë, por do të ishte dobësuar në mënyrë serioze. Fatmirësisht, ekziston një alternativë: Kthehuni te bordi i hartimit të paktit, dhe deklaroni që Marrëveshja e Tërheqjes përfundoi me sukses - pa çështjen irlandeze



Evropa do të jetë më e fortë se kurrë, blloku gjendet vetë në një situatë delikate. Brexit ka rreziqe financiare, të cilat Brukseli vazhdon t'i injorojë me kokëfortësi: Një përqindje e shpërpjesëtuar e shërbimeve financiare që kompanitë firmat e BE-së, duhet të menaxhojnë rrezikun e listimit në Bursën e Londrës, dhe kjo e fundit do të vazhdojë të jetë vendi ku duhet të bihen këto shërbime. Ka ndërkohë edhe rreziqe politike dhe të reputacionit. Teksa procesi i negociatave shpërbëhet, pjesa më e madhe e botës do t'i kthehet Brukselit për ta pyetur pse edhe një herë BE-ja duket e paaftë për të arritur një zgjidhje të shpejtë dhe efikase të problemeve të saj. Tek e fundit, pavarësisht BE-ja është i përbërë nga 27 ose 28 shtete, Brukseli s'mund t'u ikë problemeve që ka. Aktualisht, ekziston një rrezik shumë i madh, që klubi në fakt të përbëhet nga 27 anëtarë e gjysmë. Përgjithmonë. Unioni mund të rezistojë, por do të ishte dobësuar në mënyrë serioze. Fatmirësisht, ekziston një alternativë: Kthehuni te bordi i hartimit të paktit, dhe deklaroni që Marrëveshja e Tërheqjes përfundoi me sukses - pa çështjen irlandeze. (Politico.eu)

(Shënim: Bruno Maças, një ish-ministër i Evropës për Portugalinë, është anëtar i Institutit Hadson në Uashington. Libri i tij "Agimi i Euroazisë" ka dalë në qarkullim këtë muaj)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botes: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovassja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel, 17 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006


Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

SHBA dhe BE po i tejkalojnë kufijtë me taksën



Nga
Shirley DioGUARDI

Unë besoj se Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë tejkuluar kufijtë e tyre duke i bërë thirrje Kosovës që të shfuqizojë tatin e 100 për qind të importit nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina. Një vend sovran ka të drejtën sovranë të ngarkojë çdo gjë që dëshiron të ngarkojë. Dhe meqenëse Kosova nuk është anëtare e Bashkimit Evropian, vendimi i saj nuk ka të bëjë asgjë me BE. Përveç kësaj, është në kundërshtim me Shtetet e Bashkuara që të thonë, siç ka bërë rishtazi, se e respekton sovranitetin e Kosovës, por që Kosova duhet të pezullojë tatin. Meqenëse Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian nuk i kanë kërkuar Serbisë të njohin produktet e Kosovës apo të ndalojnë fushatën e vet diskredituese ndërkombëtare kundër Kosovës, unë besoj se ata duhet të përmbahen nga ndërhyrja në vendimin sovran të Kosovës. Unë nuk kam diskutuar me Kryeministrin e Kosovës Ramush Haradinajn për shumë vite dhe prandaj nuk jam e vetmja që mendoj se çka e çoi deri te vendimi i tij për tarifën e tregtisë.

Por unë e kam shumë mirë të njohur deklaratën e tij të përsëritur në shtypin shqiptar se Kosova është e gatshme të heq taksën sapo Serbia të njohë pavarësinë e Kosovës. Sipas mendimit tim, ky është hapi i parë që Serbia duhet ta ndërmerr nëse është e sinqertë në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Kosovën që zgjidh konfliktin serb-shqiptar dhe i vendos të dy vendet në një rrugë për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian. Është e pamundur të ar-



rihet një marrëveshje e ndërsjellë nëse Kosova dhe Serbia nuk vijnë në tryezë si shtete të barabarta dhe sovranë. Dhe është Serbia e jo Kosova, ajo që po i ndalon negociatat me qëllim të vonimit të mëtejshëm të njohjes së pavarësisë së Kosovës.

PËRCJICJA NDAJ THIRRJES PËR SHKËMBIM KUFIJSH

Thirrja e Serbisë për një shkëmbim të territorit është një përpjekje për të mohuar të drejtën e Kosovës për vetëvendosje dhe për të rihapur diskutimin e statusit të Kosovës si një komb sovran - një status për të cilin Serbia ka punuar për ta dëmtuar që nga fillimi i bisedimeve Prishtinë-Beograd në vitin 2011.

Bazuar në qasjen e Serbisë gjatë dialogut të ndërmjetësuar nga BE (që atëherë Përfaqësuesja e Lartë e BE për Punë të Jashtme dhe Politikën e Sigurisë Zonja Catherine Ashton këmbënguli se do të përfundojë në 2013 me nënshkrimin e Marrëveshjes së Brukselit),

është bërë e qartë se Serbia po shtyn për shkëmbimet territoriale për të vonuar, nëse jo për të penguar tërësisht, normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Kosovën. Është thellësisht shqetësuese të shihet se zyra e Federica Mogherinit, Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, kërkon që të varrosë njohurinë mbi favorizimin e BE-së ndaj Serbisë në të gjitha bisedimet Prishtinë-Beograd, duke e nisur një proces edhe më shkatërrimtar të shkëmbimeve kufitare që ka shkaktuar tashmë paqëndrueshmëri në Ballkanin Perëndimor. Besoj se territori midis Serbisë dhe Kosovës mund të shkëmbehet vetëm nëse Serbia e njeh sovranitetin e Kosovës, pushon tentimin që të zgjidhte rezultatin dhe të pajtohet për një votë të lirë që mbikëqyret ndërkombëtarisht. Por ky nuk është realiteti. Beogradi këmbëngul që të merr të gjithë territorin e Kosovës në veri të lumit Ibër (në vend të vetëm një pjese më veriore të zonave me shu-

micë serbe të Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut) dhe dëshiron t'i japë Kosovës vetëm një pjesë të luginës së Preshevës në Serbinë jugore (në vend të zonave me shumicë shqiptare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit).

Serbia dëshiron të shtyjë njohjen përfundimtare të Kosovës, derisa është duke i ndjekur synimet e veta ekspansioniste (synimet që çuan deri te krijimi artificial i Republika Srpska në fund të luftës në Bosnjë në 1995). Nën këto rrethana, Shtetet e Bashkuara dhe anëtarët tjerë të bashkësisë ndërkombëtare duhet të përjashtojnë mundësinë e ndryshimeve kufitare. Për fat të mirë, Gjermania, Britania, Holanda dhe Italia e kundërshtojnë këtë ide. Në fundi, nuk ka as konsensus politik as mbështetje publike në Kosovë për një shkëmbim të territorit. Sondazhet e kryera nga Instituti Demokratik i Kosovës në shtator të vitit 2018 tregojnë se 75 për qind të anketuarve janë kundër ndryshi-



Thirrja e Serbisë për një shkëmbim të territorit është një përpjekje për të mohuar të drejtën e Kosovës për vetëvendosje dhe për të rihapur diskutimin e statusit të Kosovës si një komb sovran - një status për të cilin Serbia ka punuar për ta dëmtuar që nga fillimi i bisedimeve Prishtinë-Beograd në vitin 2011

meve kufitare dhe Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi nuk e ka mbështetjen e Kuvendit të Kosovës për të bërë një shkëmbim të territorit si pjesë të fazës përfundimtare të negociatave.

PSE KOSOVA DUHET TË QËNDROJË NË KURSIN E VETË?

E vetmja mënyrë që Kosova mund të ketë sukses është nëse qeveria e saj dhe populli i saj qëndrojnë në kurs të vet. Është koha që elita politike kosovare të merr një qëndrim pro-aktiv drejt së ardhmes së Kosovës dhe të imponojë reciprocitet të plotë ndaj Serbisë. (Siç e thashë më parë, imponimi i Kryeministrit Haradinaj për tatin 100 për qind të Kosovës është hapi i parë). Kosovarët duhet të insistojnë që bashkësia ndërkombëtare të respektojë sovranitetin e Kosovës.

Urime Dita e Pavarësisë!



Nga
Agron BAJRAMI

Në 11-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë, Kosova zor se mund të duket më keq: Kufijtë po ia konteston presidenti i vet, marrëdhëniet me Amerikën po ia acaron kryeministri i vet, përçarjet dhe mospajtimet ia kanë zënë peng Kuvendin e vet, ndërsa arteriet kryesore të shoqërisë së saj - prej shëndetësisë e arsimit deri tek ekonomia dhe siguria - i janë bllokuar nga pakënaqësitë e mbledhura me vite tek qy-

tetarët e saj. Grevat e protestat na janë bërë përditshmëri, sikur edhe lajmet për keqpërdorime të buxhetit dhe tender të fiksuar. Kemi Qeverinë më të madhe dhe ministrat më të pasur në rajon, ndërsa mbetemi vendi më i varfër në rajon, i izoluar nga Evropa dhe i flakur nga pjesa dërrmuese e botës si një dele e zezë. Në mungesë të përparimit të vendit dhe shtetit tonë, na mbetet vetëm t'u gëzohe mi të arriturave dhe sukseseve të

individëve tanë nëpër botë, prej të cilëve shumica jo që nuk kanë pasur asnjë përkrahje nga shteti, por vetëm e kishin pengesë.

Atë ditë kur është shpallur Pavarësia e Kosovës, por edhe shumë kohë para se të shpallej - kur kemi nisur ta ëndërrojmë - nuk e kemi paramenduar kështu fillimin e dekadës së dytë të shtetësisë.

E megjithatë, nuk mund të themi se jemi zënë në befasi.

Shenjat i kemi parë që prej fillimit: qysh më 17 shkurt 2008 vendi ishte tashmë i kapur nga individë me interesa të ngushta e personale, të gatshëm të manipulojnë çdokënd e të sakrifikojnë gjithçka, që vetes t'ia ruajnë pushtetin dhe përfitimet.

Andaj, nuk është për të shprehur habi pse sot asgjë nga ajo Kosova e 17 shkurtit nuk është e

garantuar - as sovraniteti i popullit, as integriteti territorial, as rendi kushtetues, as sistemi demokratik. Në Republikën e Kosovës, sot gjithçka është e negociueshme...

... ama ende është Republikë. Dhe sa të jetë, ka shpresë se gjërat mund të ndryshojnë. Shpejt e për të mirë.

Urime Dita e Pavarësisë!

(koha.net)

PËRVJETORI I FTOHTË



Ftohta e raporteve me vendet që Kosova i ka cilësuar si mike, bashkë me sfidat e përhershme si zhvillimi i ngadalshëm ekonomik, papunësia dhe izolimi në mungese të liberalizimit të vizave, për shumë kë në Kosovë ka ndikuar që 11-vjetori i pavarësisë të shihet si një përvjetor i ftohtë

Kosova po shënon 11-vjetorin e pavarësisë pa e përmbyllur ende finalen e madhe të dialogut me Serbinë, për t'i dhënë fund armiqësisë dhe arritjes së një marrëveshjeje paqësore, historike. Dita e pavarësisë, për herë të parë po shënohet edhe me Ushtrinë në konsolidim e sipër, por Kosova mbetet ende vendi më i izoluar në Evropë, pa liberalizim të vizave.

Në përvjetorin e kaluar, i cili shënoi jubileun e parë, Kosova kishte 116 njohje nga shtetet e ndryshme, kurse sivjet, nuk dihet se cili është ky numër i njohjeve, ngaqë disa shtete kanë vendosur të tërheqin vendimin e tyre, duke pritur rezultatin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shteti më i ri evropian, edhe këtë përvjetor e shënon pa e siguruar ulësen që i takon në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Po ashtu, Kosova nuk e ka ende as mbështetjen unike të Bashkimit Evropian, nga se pesë shtete anëtare të BE-së, nuk e njohin atë si shtet.

Duke qenë me një subjektivitet të papërfunduar ndërkombëtar, Kosova përfaqësohet nëpër organizata e mekanizma ndërkombëtarë, diku si shtet sovran, diku si vëzhgues, e diku me fusnotë në emrin e saj. Më 17 shkurt 2008, Kosova në koordinim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet perëndimore shpall aktin e pavarësisë, por tani, 11 vjet pas, për herë të parë po rivlerësohet ky partneritet. Dështimi i Kosovës që

SHTETI, GARDIAN I LIRISË DHE PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli ka uruar qytetarët për 11-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Veseli tha se shteti i Kosovës do të jetë gardian i lirisë. "Shteti ynë ka lindur për të qëndruar përgjithmonë gardian i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës", shkroi Veseli në rrjetin social Facebook.



të jetë pjesë e Organizatës Botërore të Policisë - INTERPOL, që erdhi si pasojë e fushatës së Serbisë kundër këtij anëtarësimi, solli si kundër-reagim përgjigjen e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e tarifës doganore 100 për qind ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Sot, ky vendim po e sfidon Kosovën në planin ndërkombëtar, ngaqë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian kanë shprehur pakënaqësinë e hapur me tarifën e vendosur nga Prishtina zyrtare, sepse po e shohin atë si pengesë serioze për vazhdimin e dialogut dhe mundësinë për arritjen e një marrëveshjeje historike ndërmjet

Kosovës dhe Serbisë. Pengesat në dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë cilësuar si dëmim të interesave amerikane, duke e vënë kështu për herë të parë në pikëpyetje partneritetin me Kosovën, shtetin që në hulumtimet e ndryshme, zakonisht ka qenë më pro-amerikan në Evropë.

Ftohta e raporteve me vendet që Kosova i ka cilësuar si mike, bashkë me sfidat e përhershme si zhvillimi i ngadalshëm ekonomik, papunësia dhe izolimi në mungese të liberalizimit të vizave, për shumë kë në Kosovë ka ndikuar që 11-vjetori i pavarësisë të shihet si një përvjetor i ftohtë. Ndërkaq, nga


aspekti i sundimit të ligjit, përveç luftës së brendshme kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit, Kosova pritet të ballafaqohet edhe me proceset e para gjyqësore që mund të inicoohen nga Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, që ndryshe njihen me emrin unik, Gjykata Speciale për krime lufte. Sidoqoftë, për këto 11 vjet, Kosova është bërë anëtare e shumë organizatave ndërkombëtare, përfshirë edhe organizatat më të rëndësishme financiare si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim si dhe atyre sportive, duke veçuar anëtarësimet në FIFA, UEFA dhe Komitetin Olimpik. Flamuri i Kosovës është ngritur lartë nën tingujt e himnit shtetëror para syve të botës me kampionen olimpike e botërore, Majlinda Kelmendi. Kurse emri i Kosovës, lakohet për të mirë në opinionin dhe mediat botërore përmes yjeve me origjinë nga Kosova, por që kanë krijuar famë botërore, ku veçohen këngëtares Rita Ora, Dua Lipa e Era Istrefi. (REL)

PËRJETË MIRËNJOHËS NDAJ AMERIKËS PËR PAVARËSINË

Presidenti i vendit Hashim Thaçi ka uruar për 11-vjetorin e pavarësisë së Kosovës me ç`rast edhe i është falënderuar miqtë të Kosovës, me theks të veçantë Amerikës për kontributin për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. "Shpallja e Pavarësisë së Kosovës para njëmbëdhjetë vjetëve ishte akti historik më sublim që institucionalizoi



përpjekjet tona për liri. Për këtë të arritur të gjithë qytetarët tanë janë meritore. I falënderojmë të gjithë miqtë tanë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. U jemi mirënjohës përjetë!", ka shkruar Thaçi në një postim në "Facebook".



Kosova, një 11-vjeçar i llastuar, ende i papërgjegjshëm

Kosova, dje ka mbushur plot 11 vjet. Pavarësisht se ka korrur suksese, Kosova ka ngecur në shumë fusha të ndryshme. Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari - Lila, në një intervistë për Koha.net, i ka vlerësuar këto 11 vite të Kosovës së pavarur. Kur është pyetur se si e ka parë Kosovën në 11 vjet shtet, ajo ka thënë se e ka parë si "Një njëmbëdhjetë-vjeçar i llastuar por ende i papërgjegjshëm për përgjegjësitë që ka". "Kosova 11 vjet shtet kemi menduar që do të ishte fëmijë më i përgjegjshëm, një shtet i ri më i përgjegjshëm. Kemi dështuar në disa pika. Nuk po i respektojmë ata që na kanë ndihmuar në rritjen tonë, por uroj që sfidat të na kenë forcuar e të na japin mend. Nuk kemi mësuar nga gabimet e të tjerëve, kemi insistuar t'i bëjmë gabimet vetë dhe kjo është Kosova 11 vjet. Ka ardhur momenti që Kosova në 12, 13, 14 vjet shtet të fillojë të rritet e të marrë përgjegjësi për jetën e qytetarëve brenda që ta kemi Kosovën me njerëz sepse s'na duhet një Kosovë e zbrazët ku forca profesionale ikë në shtete tjera", është shprehur Kusari - Lila, ka thënë Kusari - Lila për Koha.net.



Pavarësia, kurorëzim i sakrificave

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, u ka uruar të gjithë qytetarëve të Kosovës 11-vjetorin e pavarësisë. Sipas Mustafës, shpallja e pavarësisë ishte "momenti më i rëndësishëm në historinë e re të Kosovës".

"Pavarësia është kurorëzim i

sakrificave dhe punës së shumë gjeneratave ideali i të cilave ishte liria. U jemi mirënjohës arkitektit të pavarësisë presidentit historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, familjes së Komandantit legjendar Adem Jashari, dëshmorëve të Kombit dhe të gjithë atyre që

dhanë kontribut për ta fituar me mund këtë ditë", ka thënë Mustafa, thuhet në një komunikatë për media të LDK-së. Kreu i LDK-së ka thënë se Kosova arriti të shpallë pavarësinë falë përkrahjes së Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të tjerë perëndimorë.

"Vlerat e pavarësisë dhe ndërtimit e zhvillimit demokratik të vendit tonë, janë vlera të përbashkëta që i ndajmë me miqtë dhe aleatët tanë ashtu siç e ndajmë përgjegjësinë tonë për kultivuar ato edhe në të ardhmen", ka thënë Mustafa.

Në vitet e shtetësisë, Kosova ende vuan nga shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë, edhe pse ndër vite ka pasur rënie. Në vitin 2008 papunësia ishte mbi 43 për qind, ndërkaq 45 për qind e popullsisë jetonin në varfëri relative. Kurse vitin e kaluar, sipas të dhënave zyrtare, shkalla e papunësisë ishte 30 për qind, derisa rreth 17.6 për qind të popullatës jeton në varfëri të plotë

11 VITET E NGADALTA EKONOMIKE



Kosovës (ASK), në vitin e pavarësisë niveli i rritjes ekonomike ka qenë 4.5 për qind, kurse ndër vite, kryesisht ka shënuar rënie, ndërkaq vitin e kaluar rritja ekonomike në Kosovë ka arritur në 4.2 për qind. Me fokus të veçantë gjatë kësaj periudhe, ekspertët dhe ish-zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, përmendin trendin e rënies së investimeve të huaja. Investimet e huaja, që para zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës, zyrtarë të Qeverisë dhe ekspertë për çështje ekonomike, vlerësonin se vlera e investimeve do të rritet për shkak se Kosova konsiderohet se ka resurse të mjaftueshme për investitorët e huaj, pas shpalljes së pavarësisë ndodhi e kundërta. Në vitin 2007, shumica e investimeve të huaja kishte arritur në 440 milionë euro, në vitin 2008, 355 milionë euro, vlerë kjo që asnjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës nuk ka arritur në Republikën e Kosovës.

Ndërkaq, sipas të dhënave zyrtare, në nëntë muajt e vitit të ka-

luar, vlera e investimeve të huaja, ka arritur në 164 milionë euro. Importi që vitin e kaluar ka arritur në 3 miliardë euro, kurse eksporti nga Kosova mbulohe vetëm 10 për qind në këtë import. Për dallim nga rritja ekonomike dhe investimet e huaja, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, është rritur shumica e dërgesave të emigrantëve. Në vitin 2008 vlera e remitencave ishte 409 milionë euro, përderisa në vitet tjera, vlera e parave të dërguara nga diaspora, brenda një viti arrin shumën rreth 600 milionë euro. Edhe pse shfrytëzimi i tyre është orientuar më tepër në paturndshmëri dhe konsum, sipas ekspertëve, kjo ndikon në rritjen e përmirësimit të mirëqenies sociale.

Element tjetër negativ, gjatë kësaj periudhe është emigracioni i fuqisë së kualifikuar punëtore. "Një element tjetër negativ që unë e shoh gjatë këtyre viteve të pavarësisë, sidomos gjatë viteve të fundit, është ikja e fuqisë punëtore të kualifikuar në vendet e Bashkimit

Evropian, kryesisht në Gjermani dhe Zvicër. Dhe rreziku kryesor i zhvillimit ekonomik të Kosovës, vjen kryesisht nga emigracioni i fuqisë së kualifikuar punëtore dhe ikjes së trurit, kuadrove të profesionalizuar të profileve të larta", thuhet në hulumtime të Radios Evropa e Lirë. Në vitet 2014-2015, mijëra qytetarë në mënyrë të paligjshme kishin braktisur Republikën e Kosovës për shkak të, siç thuhet, "një perspektive më të mirë në vendet e Bashkimit Evropian". Megjithatë, në vitet e shtetësisë, Kosova ende vuan nga shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë, edhe pse ndër vite ka pasur rënie. Në vitin 2008 papunësia ishte mbi 43 për qind, ndërkaq 45 për qind e popullsisë jetonin në varfëri relative. Kurse vitin e kaluar, sipas të dhënave zyrtare, shkalla e papunësisë ishte 30 për qind, derisa rreth 17.6 për qind të popullatës jeton në varfëri të plotë.

Paga mesatare për punonjësit në institucionet publike në Kosovë ka arritur në rreth 500 euro, kurse

paga në sektorin privat, 384 euro në muaj. Paga minimale në Kosovë është 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç, dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç. Kurse, shporta mujore e një qytetari në Kosovë llogaritet të jetë 115 euro, konsumi për ekonomitë familjare mbi 7500 euro në vit, shumë kjo që nuk siguron një standard të mirë jetësor për qytetarët. Po sipas të dhënave të zyrtare të ASK-së, Bruto Produkti Vendor për vitin 2017 ishte mbi 6.4 miliardë euro, kurse Bruto Produkti Vendor për kokë banori ka qenë 3566 euro, vlera këto më të ulëta, krahasuar me vendet e rajonit. Pavarësisht faktit se Kosova llogaritet e fundit sa i përket standardit jetësor, krahasuar me vendet e rajonit, të dhënat e Agjencisë të cilat përfshijnë periudhën 2008-2017 tregojnë se gjatë kësaj periudhe, vazhdimisht ka pasur rritje të BPV-së, pasi në vitin 2008 kjo normë ka qenë 2.200 euro për kokë banori.

Pavarësisht, këtyre shifrave, edhe në Kosovë figurojnë milionerë me pasuritë e tyre, ku përveç biznesmenëve, milionerë janë edhe zyrtarë të lartë të institucioneve qendrore dhe lokale. Por, Kosova vazhdon të kritikohet nga institucionet ndërkombëtare për nivel të lartë të korrupsionit. Sidoqoftë, gjatë periudhës së shtetësisë, Kosova është anëtarësuar në disa institucione ndërkombëtare financiare, si në Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ekonomike për Rindërtim dhe Zhvillim, kurse nga viti 2016 ka hyrë në fuqi zbatimimi i Marrëveshjes së Stabilitetit Asocimit (MSA).

Komandant, forca jonë është në rresht me ushtritë e paqes




Me rastin e 11 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj ka bërë homazhe në kompleksin "Adem Jashari" në Prekaz së bashku me të tjerë liderët shtetërorë. Haradinaj përmes një shkrimi në Facebook ka thënë se nderimi për Jasharajt dhe kryekomandantin Adem Jashari është i përjetshëm. Familja Jashari ka ndry-

shuar rrjedhën e historisë sonë të re ka thënë mes tjerash Haradinaj. Shkrimi i plotë i Haradinajt: "Në Prekaz, aty ku buron liria, nderimi është i përhershëm për Jasharajt dhe Kryekomandantin Adem Jashari, të cilët ndryshuan rrjedhën e historisë sonë të re. Komandant, në 11-vjetorin e Pavarësisë, Forca jonë është në rresht me ushtritë e paqes!".

Ndërkohë, në mbledhjen solemne të Qeverisë me rastin e 11 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Haradinaj tha se Pavarësia jeton tek të gjithë qytetarët e Kosovës, pasi secili e ka të kultivuar në këto 11 vite.

"Edhe kjo qeveri e ka rrëfimin e vet. Ajo që mendoj ta konfirmojmë është që me kujdesin më të madh jemi përballur me të gjitha temat që janë përballuar, ka shumë vendime dhe ligje e pako ligjore dhe vendime të mëdha si ishte ushtria, si ishte vendimi për Trepçën. Ajo që dua të them është se në 10 vjetorin e dytë është periudha e konsolidimit tonë si shtet dhe e kemi edhe marrëveshjen ligjrisht të obligueshme me Serbinë dhe anëtarësimi ynë në NATO. Gjatë rrugëtimit tonë kemi hasur në sfida, do të sfidohejmi prapë, por Kosova nuk e ka luksin të bëjë hapa prapa dhe do ua shpjegojmë partnerëve tanë që Kosova nuk ka mundësi të bëjë hapa prapa pëse e dobëson Kosovën", ka thënë ai.



Pllakate "11 vjet pushtim" në Mitrovicën veriore

Në 11-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, Mitrovica veriore ka gdhirë me pllakatet "11 vjet pushtim - 17.2.2008 - 17.2.2019 ("11 godina okupacije - 17.2.2008. - 17.2.2019. godine"). Në pllakatet me ngjyrë të zezë paraqiten dy duar me ngjyrë të bardhë me pranga dhe me gishtat e mesëm të ngritur, ka njoftuar agjencia serbe e lajmeve Tanjug. Pllakatet janë vënë nëpër rrugët kryesore të Mitrovicës veriore. Në këtë pjesë të Mitrovicës, serbët nuk janë shumë të interesuar ta krenojnë 11 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, transmeton agjencia.

Diplomacia agresive e Serbisë është manifestuar jo vetëm me përpjekjet për të ndaluar njohjet e reja dhe pengesat për anëtarësimin e Kosovës në organizata e mekanizma ndërkombëtarë, por Beogradi po vazhdon t'iu kërkojë vendeve të caktuara që të tërheqin njohjet e shtetit të Kosovës

VITI I MBRAPSHT I (Ç)NJOHJEVE PËR KOSOVËN



Viti 2018 dhe fillimi i 2019-ës janë periudhat kur Kosova nuk ka arritur të fuqizojë subjektivitetin ndërkombëtar përmes njohjeve të shumta dhe ashtu sikurse edhe në vitin 2017, Kosova ka arritur vetëm një njohje të shtetit të saj, thonë njohësit e zhvillimeve politike. Për më tepër, sipas tyre, Kosova është ballafaquar me dilemën nëse disa nga vendet që e kanë njohur pavarësinë e saj, i kanë tërhequr ato njohje.

Zyrtarët e Qeverisë së Serbisë kanë theksuar se gjatë viti 2018 kanë qenë 12 shtete që i kanë tërhequr njohjet e tyre për Kosovën, ndërkohë që zyrtarët e Qeverisë së Kosovës, kanë hedhur poshtë një gjë të tillë, duke i cilësuar si propagandë agresive të Serbisë për ta dëmtuar subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Taulant Kryeziu nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK), duke folur për Radion Evropa e Lirë, thotë që problemi më i madh është vetë fakti se është bërë çështje e diskutueshme se a ka marrë ndonjë vend i caktuar vendim politik për çnjohje ose jo të shtetit të Kosovës.

“Nuk jemi më as në kohën kur flasim për njohje të reja. Përderisa

në vitin 2012 kemi pasur 12 njohje, shikoni si ka rënë trendi i njohjeve vit pas viti. Më 2018 dhe 2017, ne kemi nga një njohje të vendeve. Prandaj, në këtë kontekst, unë e shoh që tanimë jemi në fazë defensive, vetëm për të krijuar një lloj ambienti që të mos kemi së paku vendime politike për çnjohje nga vendet e caktuara. Çështja e njohjeve të reja nga vendet tjera më nuk as nuk po diskutohet”, theksoi Kryeziu. Çështja nëse vende të caktuara kanë tërhequr njohjet e tyre ndaj Kosovës është bërë temë diskutimesh, përveç në opinionin publik, edhe brenda institucioneve të Kosovës.

Më 19 dhjetor, zëvendëskrye-

ministri dhe ministri i Punëve të Jashtme i Qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli, duke iu përgjigjur pyetjeve të Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, ka hedhur poshtë pohimet e autoriteteve serbe se 12 vende kanë tërhequr njohjet për Kosovën. Megjithatë, ai ka pranuar se një vend ka dërguar notën verbale, për tërheqje të njohjes.

“Republika e Kosovës ka gjithsej 116 njohje të dëshmuara me 116 nota verbale, të cilat janë lëshuar nga shtetet respektive në emër të Republikës së Kosovës. Njohjet dhe notat verbale kanë ardhur te ne. Deri më sot, asnjë notë verbale, përveç Ishujve Solomon, nuk ka

ardhur asnjë shkresë te ne, ku thuhet se ‘ne jemi duke tërhequr njohjen, jemi duke u tërhequr nga marrëdhëniet me Kosovën’ ose diçka tjetër”, tha Pacolli. Megjithatë, ai ka theksuar se ekzistojnë disa nga vendet që shqyrtojnë ose kanë ngrirë qëndrimin edhe ndaj Kosovës, por edhe ndaj Serbisë.

Në anën tjetër, ministri i Punëve të Jashtme i Qeverisë së Serbisë, Ivica Dačić, është shprehur se diplomacia serbe ka ndikuar në tërheqjen e njohjeve të vendeve të caktuara për Kosovën. “Janë 12 vende që e kanë tërhequr pranimin e Kosovës. Sa i përket kësaj, ne e kemi situatën që ka një numër të

vendeve, për të cilat nuk e dimë se a e kanë njohur ose jo Kosovën. Madje as ata vetë nuk e dinë”, theksoi Dačić. Sidoqoftë, zyrtarët e Qeverisë së Kosovës, më herët kanë theksuar se ka kohë që ekzekutivi ka aktivizuar mekanizmat e saj diplomatikë për t’u përballur me agresivitetin diplomatik të Serbisë. Diplomacia agresive e Serbisë, sipas tyre, është manifestuar jo vetëm me përpjekjet për të ndaluar njohjet e reja dhe pengesat për anëtarësimin e Kosovës në organizata e mekanizma ndërkombëtarë, por Beogradi po vazhdon t’iu kërkojë vendeve të caktuara që të tërheqin njohjet e shtetit të Kosovës.

POROSIA E AMBASADORIT KOSNETT PËR PAVARËSI

Paqe, drejtësi dhe mbarësi

Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip S. Kosnett, ka uruar 11 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. “Kam nderin dhe privilegjin që shërbej si ambasador i SHBA-së gjatë kësaj kohe emocionuese. Jam kthyer në Kosovë pas 15 viteve dhe e shoh që populli i Kosovës ka arritur përparim të jashtëzakonshëm në rindërtimin e vendit dhe është përgatitur për sukses në skenën botërore. Gjithmonë mahnitem nga të rinjtë e Kosovës: të rinj të zgjuar, energjikë, kreativë, që kërkojnë mundësi për ta ndërtuar të ardhmen e tyre këtu në Kosovë”, ka thënë Kosnett.

Kosnett, tutje ka thënë se të dy vendet kanë përfituar nga partneriteti i ngushtë ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës dhe, siç thotë Kosnett, “nuk kam asnjë dyshim që partneriteti ynë do të vazhdojë në të ardhmen e largët”. “Por, mos u gaboni. Kosova tani është në dhjetëvjeçarën e dytë të pavarësisë dhe demokracisë. Lu takon

kosovarëve që të marrin përgjegjësi dhe t’iu kërkojnë llogari udhëheqësve për të marrë hapat e nevojshëm për përparim”, ka thënë tutje, përcjell Koha.net.

“Sa herë që udhëtoj nëpër vend dëgjoj që qytetarët kosovarë i duan tri gjëra për familjet dhe vendin e tyre: paqe, drejtësi, mbarësi. Unë besoj se një vend nuk mund të presë të arrijë sukses në njërin nga këto fusha pa pasur sukses edhe në fushat tjera.

Arritja e paqes do të kërkojë marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë, që në thelb e ka njohjen e ndërsjellë. Arritja e drejtësisë nënkupton veprime konkrete për të ndërtuar sundimin e ligjit dhe luftimin e korrupsionit në të gjitha nivelet.

E ndërtimi i mbarësisë nënkupton përpjekje më të mëdha që do të nxisin investimet ndërkombëtare dhe zhvillim ekonomik”, ka thënë ambasadori amerikan.

Kosnett, tutje thotë se sigurimi i kësaj të



ardhmeje do të kërkojë udhëheqje të matur politike, qytetari të angazhuar, si dhe përkushtim për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallim gjinie, feje e etnie. “Jam i bindur se populli i Kosovës është i aftë të përballlet me sfidat që i ka përpara. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të jenë përkrah jush. Urime Dita e Pavarësisë, Kosovë!”, ka përfunduar urimin me mesazhe Kosnett.

11 vjet PAVARËSI

Vetëvendosja: 11 vjet PA“VARËSI”

Lëvizja Vetëvendosje, ka zgjedhur një mënyrë tjetër të uroj 11 vitet e Pavarësisë së Kosovës. Ndajfoljen mohuese “PA”, e ka paraqitur para fjalëve si “Viza”, “Punë”, “Mirëqenie”, “Shëndetësi”, “Drejtësi”,



Majlinda, vula më e fuqishme e Kosovës

Driton Kuka e ka uruar 11-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës duke e kujtuar rëndësinë e ambasadores më të mirë të sportit kosovar në botë, Majlinda Kelmendi. Majlinda Kelmendi u bë sportistja e parë që i solli Kosovës medalje olimpike, dhe atë në stil, duke e fituar medaljen e artë në xhudo në Lojërat Olimpikë Verore Rio 2016 në Brazil. Në një postim në profilin e tij zyrtar në Facebook, trajneri Driton Kuka e ka postuar një fotografi të Majlindës me mbishkrimin: "Vula më e rëndësishme". Kelmendi është dy herë kampione e botës në xhudo, si dhe tri herë kampione evropiane dhe fituese e shumë medaljeve të ndryshme në turnetë e rëndësishëm botëror në xhudo. Në njëmbëdhjetet e saj si shtet i pavarur, Kosova është përfaqësuar më së miri dhe më denjësisht nga Majlinda.



Pavarësia e Kosovës, humanisti i njohur dhuron 17 shtëpi për të varfrit

Humanisti dhe themeluesi i shoqatës bamirëse "Jetimët e Ballkanit", Halil Kastrati, para disa ditësh njoftoi se me rastin e 11 vjetorit të pavarësisë së Kosovës do të dhurojë 17 çelësa banesash për familjet në nevojë. Ai ka bërë të ditur se tanimë i ka ndarë çelësat për familjet e përzgjedhura. Në një postim në Facebook, Kastrati ka publikuar foto të 17 çelësave, duke thënë se po gëzohen 17 familje të reja. "Dhurimi i 17 palë çelësave për nder të 17 shkurtit. Po gëzohen 17 familje me banesa te reja", njoftoi ai.



Nga të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), të dërguara gazetës "Zëri", bëhet e ditur se në Kosovë janë gjithsej 43

URIME DHE MESAZHETË KODUARA NGA POLITIKA SHQIPTARE

MË SHUMË UNITET



"MIRËMËNCJES dhe me urimin për ditëlindjen e shtetit të Kosovës, ju dëshiroj një të diel të bukur të gjithëve", shkroi Rama në Facebook në një postim të shoqëruar me simbolet kombëtare

Ballkani gjendet në kulmin e një debati për korrigjim kufijsh dhe tensioneve midis shteteve, por Kosova festoi dhe 11-vjetorin e Pavarësisë dhe urimet për këtë datë historike kanë ardhur edhe nga Shqipëria. Ndër të parët që uruan për ditëlindjen e shtetit të Kosovës ishin kryeministri Edi Rama dhe Presidenti Ilir Meta, të cilët duket se janë rreshtuar në agjenda të ndryshme përsa i përket kufirit Kosovë-Serbi.

"MIRËMËNCJES dhe me urimin për ditëlindjen e shtetit të Kosovës, ju dëshiroj një të diel të bukur të gjithëve", shkruan Rama në Facebook, në një postim të shoqëruar me simbolet kombëtare. Ndërkohë, Meta nëpërmjet një letre që i ka dërguar Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi ka shprehur "mirënjohje të

gjithë vizionarëve dhe heronjve që luftuan, sakrifkuan dhe punuan për Kosovën e pavarur!". "Kam besim se kjo ditë e shënuar do të frymëzojë më shumë përpjekje, më shumë unitet dhe më shumë devotshmëri për të konsoliduar institucionet shtetërore, për një Kosovë më të begatë dhe europiane që forcon sigurinë dhe stabilitetin në rajonin tone", shkruante Krua i Shtetit në urimin e tij.

Ai gjithashtu ka ndarë në Facebook dy foto nga zyra e kongresmenit amerikan Eliot Engel, një mbështetës i flaktë e i çështjes shqiptare, ku Meta është duke parë një kopje të deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Edhe ministri për Diasporën Pandeli Majko, i cili është ndër të rrallët politikanë shqiptar që gëzon edhe shtetësinë kosovare, ka uruar

vëllezërit tanë për këtë ditë të gëzuar.

Majko ka uruar ditëlindjen e 11-të të shtetit të Kosovës me një mesazh në foton e komandantit legjendar të UÇK-së Adem Jashari. "Gëzuar përvjetorin e pavarësisë Kosovë...", shkruan Majko, ndërsa në foton e Jasharit shkruhet "Të gjithë dhanë diçka, por dikush i dha të gjitha".

Ndërkohë, ish-ministri i Jashtëm, Dimitir Bushati në urimin e tij për ditëlindjen e 11-të të Kosovës, duket se ka dërguar indirekt edhe një mesazh për ata që janë rreshtuar pro shkëmbimit të territoreve me Serbinë. "Gëzuar ditën e pavarësisë Kosovë! Kosova shtet është produkt i sakrificës për liri dhe rendit ndërkombëtar të bazuar mbi respektin për të drejtat e njeriut. #Mirënjohje", shprehet Bushati.

"NEWBORN" mbush 11 vjeç dhe transformohet për Pavarësinë

Krijuesi i obeliskut "NEWBORN", që është vendosur në qendër të Prishtinës nëpërmjet një postimi në Facebook ka treguar kuptimin e transformimit të obeliskut në ditëlindjen e 11 të tij dhe shtetit të Kosovës.

Fisnik Ismaili, që është njëherësh edhe deputeti i PSD-së, thotë se për 11 vjetorin e Pavarësisë, mesazhi është "ruaje tënden".

"N - nature/natyrë. E - energy/energji. W - Water/ujë. B - bio/jetë. O - oxygen/oksigen. R - recycle/riciklim. N - nature/natyrë. Ruaje tënden. #NEW-



BORN11", ka shkruar Ismaili.

Obeliskut "NEWBORN" çdo përvjetor të Pavarësisë, i ndryshohet pamja,

teksta i jepen ngjyra dhe mesazhe të ndryshme që ndërlidhen me historinë e Kosovës.

46 "Kosova" në Republikën e Kosovës

persona me emrin "Pavarësi" (42 vajza dhe një djalë).

Të shumtë janë qytetarët e Kosovës të cilët gjatë viteve ua kanë vënë fëmijëve emrin e shtetit të tyre, Kosovës. Në shtetin që i ka rreth dy milionë banorë gjenden gjithsej 46 persona me emrin "Kosovë", 13 prej të cilave janë të gjinisë femërore e 33 të gjinisë mashkullore. Njëri nga ta është edhe

gazetari Kosovë Gjoci, i cili vjen nga komuna e Istogut. Me fjalën "krenar" Gjoci tregon më së miri se si ndihet që mban emrin e vendit ku është lindur dhe rritur. Teksa rrëfen për "Zërin" se si i ishte vënë emri që mban, gazetari kosovar thotë se ndihet tejet mirë që emri i tij është Kosovë.

"Emrin 'Kosovë' ma ka lënë gjyshi im. Vendimi për këtë ka lidhje

me një veprimtar të asaj kohë - Kosovë Rexhë Balaj, i cili nuk jeton më. Gjyshi im e ka pasur të afërm (tezak) dhe shok në të njëjtën kohë. Në vitin kur u lindi unë për shkak të përndjekjes nga pushteti i atëhershëm, pasi ka qenë disa herë në burg për veprimtari atdhetare, ai është detyruar të ikë në Shqipëri fillimisht dhe pastaj në Suedi", rrëfen Gjoci.

Sadiku: Jam i lumtur për golin që shënova

Armando Sadiku shënon në një ndeshje zyrtare pas plot 15 muajsh. Sulmuesi i Kombëtares shqiptare e kishte harruar shijen e golit që më 13 nëntor të vitit 2017, kur bënte dopietë me fanellën kuqezi në miqësoren e fituar 2-3 ndaj Turqisë. Sulmuesi luajti për herë të parë titullar me Luganon dhe hapi serinë e golave në fitoren 0-3 në transfertë ndaj Luzernës. "U ndjeva shumë mirë që në momentin që nisi ndeshja. Mora besimin nga trajneri për të luajtur titullar dhe isha i bindur që do të shënoja. Për fat ia dola. Më erdhi mirë edhe për skuadrën që fitoi, pasi kishte shumë nevojë për këtë trespikësh. Kam punuar shumë gjatë kësaj kohe dhe ndihem mirë, sepse besimi më është dhënë nga të gjithë. Familja, miqtë dhe e gjithë skuadra e Luganos më kanë qëndruar pranë", deklaroi Sadiku.



Nuhii e nis me fitore te Drita

Shkup, 17 shkurt - Nisi me një fitore në derbi aventura e Ardian Nuhii si trajner i parë i Dritës me këtë të fundit që zëvendësoi Shpëtim Duron që dha dorëheqjen pas eliminimit në Kupë nga Vëllaznimi. Djelmohat e tij arritën që të triumfojnë në derbi ndaj Gjilanit me rezultat 3-1, për t'iu afruar tani në një pikë në renditje - Drita ka 26 në pozitën e pestë, Gjilani 27 në atë të katërt. Me këtë fitore Drita iu afrua në renditje Gjilanit sepse tashmë ka 26 pikë vetëm një më pak se "skifterat", por gjithsesi të dyja skuadrat janë shumë larg kreut të renditjes. Nuhii, është shprehur shumë i lumtur me fitoren prej 3-1 në derbi ndaj Gjilanit. "Jam shumë i lumtur për këtë fitore, por më tepër jam i lumtur për futbollistët, pasi që ata e kanë merituar një fitore të tillë. Është punë e përbashkët me profesor Duron. Dua t'i falënderoj drejtuesit e klubit për besimin. Kemi bërë një ndeshje të mirë, me ç'rast krijua shumë raste dhe me meritë e fituam ndeshjen. Ndoshta se kam qenë vetë sulmues si futbollist, ndaj edhe kërkoj lojë sulmuese. "Këta futbollistë dinë të luajnë futboll sulmues dhe ne do të nxjerrim më të mirën nga ta. Futbolli do vazhdimësi dhe ne do marrim ndeshjet me radhë. Do mundohemi që të mbajmë ekipin sa më lartë dhe të përgatitemi për edicionin e ri", deklaroi trajneri shkupjan, Ardian Nuhii.

LIGA E PARË - JAVA E 19

SHKËNDIJA FITON DERBIN NDAJ VARDARIT

Lideri i tabelës Shkëndija ka arritur të fiton derbin e javës së 19 ndaj Vardarit, falë golit të Omar Imerit. Skuadra e Shkupit ka arritur në minutat shtesë të nxjerr barazim në Kratovë, duke luajtur 2-2 me Sileksin

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 17 shkurt - Me derbin e javës së 19, mes Shkëndijës dhe Vardarit filloi sezoni i pranveror në Ligën e Parë futbollistike të Maqedonisë. Në stadiumin e qytetit në Tetovë, para 10 mijë shikuesve falë golit të shënuar nga Omar Imeri në minutën e 23, Shkëndija ka arritur të shënon fitore ndaj Vardarit. Goli i futbollistit shkupjan erdhi pas një aksioni të gjatë të skuadrës tetovare, e cila dominoi në tërësi 45 minutëshin e parë. Në pjesën e dytë të dyja ekipet kërkonin golin mirëpo



me shifrat e pjesës u mbyll derbi i javës së 19. Pas kësaj fitore "kuqezinjtë" nga Tetova përforcojnë kreun e tabelës, tani me 8 pikë më shumë se ndjekësi Vardari. Skuadra e Shkupit ka arritur në minutat shtesë të nxjerr barazim në Kratovë, duke luajtur 2-2 me Sileksin. Skuadra e Sileksit me golat e Boban Georgiev dhe Marko Rajković, mbyllti pjesën e parë. Miërpo djelmohat e trajnerit Umut Karan në pjesën e dytë zhvilluan një ndeshje mjaftë të mirë duke arritur të bara-

zojnë rezultatin në 2-2 dhe të kthehen në Shkup me një pikë. Së pari në minutën e 76, futbollisti nikoqir Stefan Kocov me një autogol zvogëloi shifrat në 2:1, ndërsa në minutat shtesë, Artan Veliu shënoi golin e barazimit. Në stadiumin "Filipi i Dytë" në Shkup, Rabotnički dhe Renova luajtën me shifrat 1-1. Ishte skuadra e Rabotniçkit e para që shënoi golin e avantazhit dhe atë në minutën e 45 të pjesës së parë me anë të Petar Petkovskit. Në pjesën e dytë "gjipspunuesit" kërko-

nin golin e barazimit, kështu në minutën e 67 kishin rastin të barazonin rezultatin nga pika e bardhë, por futbollisti mysafir e dërgoi topin jashtë portës. Mirëpo skuadra e Renovës nuk u dorëzua dhe në minutat shtesë fitoi përsëri penalti, ndërsa kësaj herë ishte i saktë Mishkovski duke barazuar rezultatin në 1:1. Ekipi i Akademija Pandev me rezultatin e thellë 3:0 ka fituar ndaj Makedonija GJ.P, ndërsa Pobeda para publikut vendas ka barazuar me Bellasicën 1:1.

Roçi boksieri më luftarak në turneun e Pavarësisë



BOKSIERËT QË MORËN ÇMIME
Boksieri më i mirë - Shpëtim Bajoku
Tekniku më i mirë - Leutrim Rexhepi
Dyshja më luftarake - Riad Konushefci - Almir Roçi
Boksieri më ferplayr - Alban Beqiri
Boksieri më me perspektiv - Fatlind Ternava

Shkup, 17 shkurt - Boksieri Almi Roçi nga Veleshta (Struga) në turneun ndërkombëtar të boksit Pavarësia që u zhvillua në Prishtinë, u shpall boksieri më luftarak. Ky ishte turne i 11-ti, me radhë që organizohet nga Federata e Boksit të Kosovës (FBoxK). Raportohet se në këtë turne kishte mjaft luftëra cilësore me shumë përballje interesante.



Majlinda, vula më e fuqishme e Kosovës

Driton Kuka e ka uruar 11-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës duke e kujtuar rëndësinë e ambasadores më të mirë të sportit kosovar në botë, Majlinda Kelmendit. Majlinda Kelmendi u bë sportistja e parë që i solli Kosovës medalje olimpike, dhe atë në stil, duke e fituar medaljen e artë në xhudo në Lojërat Olimprike Verore Rio 2016 në Brazil. Në një postim në profilin e tij zyrtar në Facebook, trajneri Driton Kuka e ka postuar një fotografi të Majlindës me mbishkrimin: "Vula më e rëndësishme". Kelmendi është dy herë kampione e botës në xhudo, si dhe tri herë kampione evropiane dhe fituese e shumë medaljeve të ndryshme në turnetë e rëndësishëm botëror në xhudo. Në njëmbëdhjetet e saj si shtet i pavarur, Kosova është përfaqësuar më së miri dhe më denjësisht nga Majlinda.

GJITHNJË E MË PAK SHQIPTARË NË EKIPIN E ZVICRËS

Tërhiqet Xhemaili

Blerim Xhemaili nuk do të luajë më për Përfaqësuesen zvicerane. Me kritika ndaj trajnerit Vladimir Petković, ai tërhiqet nga ekipi helvet. Blerim Xhemaili pritet që të tërhiqet nga Përfaqësuesja zvicerane. Në një intervistë për "Neue Zürcher Zeitung", mesfushori shqiptar i Bolonjës njoftoi tërheqjen e tij, transmeton Shtegu.com. "Për mua është e qartë se tashmë gjithçka është e kaluar", tha Xhemaili. Sikurse kapiteni Stephan Lichtsteiner, Valon Behrami, Johan Djourou dhe Gelson

Fernandes, edhe ai kishte pranuar një telefonatë në muajin gusht të vitit të kaluar nga Vladimir Petković, në të cilën trajneri i ekipit kombëtar zviceran ia kishte treguar planet e tij për të ardhmen. Edhe pse Petković e kishte lënë të hapur çështjen nëse ai do ta angazhonte atë përsëri, ka pohuar Xhemaili për "NZZ", informon Shtegu.com. "Por unë nuk e di nëse do të pranoja të kthehem. Unë kurrë nuk kam qenë ai që vetëm kam dashur të jem një numër. Doja që gjithnjë të jem i rëndësi-

shëm për ekipin". Për mënyrën e komunikimit të Petkovićit mund të diskutohet ende, "por unë nuk jam ai që këto gjëra i marr kaq me shpirt". Ashtu sikurse edhe tashmë të larguarit Behrami dhe Fernandes, edhe Xhemaili nuk ishte pjesë e ekipit në vjeshtë, në kuadër të ndeshjeve të Lidhjes së Kombeve kundër Islandës dhe Belgjikës, si dhe në dy ndeshjet kontrolluese kundër Anglisë dhe Katarit. I lindur në Maqedoni dhe i rritur në Cyrih, Xhemaili ka luajtur 69 ndeshje ndërkombëtare për Zvicrën, duke



shënuar 11 gola. Angazhimin e tij të fundit e kishte në raundin e Kupës së Botës, në vitin 2018, në ndeshjen e së tetës së finales kundër ekipit të Suedisë, të cilën Zvicra e humbi me rezultat 0:1. "U ndjeva krenar për të përfaqësuar Zvicrën, ajo ka bërë përparim të madh në dekadën e fundit. Dhe unë isha pjesë e saj", ka përfunduar Xhemaili.



SOLARI I FAJËSON GAZETARËT PËR INCIDENTIN E RAMOSIT ME KARTONIN E VERDHË

Solari, ka sugjeruar se gazetarët kishin qenë mashtrues dhe të paqartë në mënyrën se si ia kishin bërë pyetjen për incidentin me kartonin e verdhë Sergio Ramosit



Si pasojë e shkarkimeve, Mourinho i ka fituar 73 milionë euro

Të mos qenit mjaftueshëm i mirë për një punë ka rezultuar të jetë një gjë mjaftueshëm e mirë për Jose Mourinhos, pasi që ai i ka fituar plot 73 milionë euro si dëmshpërblim për shkarkimin nga puna, që ka ndodhur disa herë gjatë karrierës së tij. Manchester Unitedi ka zbuluar se për ta shkarkuar Jose Mourinhon nga pozita e trajnerit të Manchester Unitedit, ata i kishin shpenzuar 22,2 milionë euro, pas dy sezoneve e gjysmë që portugezi i kishte kaluar në këtë klub. Mourinho u shkarkua pas një serie të rezultateve të këqija, por fundin e tij në këtë klub ia solli Xherdan Shaqiri me dy golat e tij në fitoren e Liverpoolit ndaj Manchester Unitedit me rezultat 3:1. Por, ish-trajneri i Portos e ka një reputacion për t'u shkarkuar në sezonin e tij të tretë, pasi që kjo gjë i ka ndodhur në Real Madrid dhe në Chelsea, e vitin e kaluar i ndodhi edhe një herë, në Old Trafford. Në vitin 2007, ai i fitoi 19 milionë euro kur u largua nga Stamford Bridge, pesë vjet më vonë i mori 18 milionë të tjera për t'u larguar nga Real Madridit. Në vitin 2015, u shkarkua përsëri nga pozita e trajnerit të Chelsea, e këtë herë i fitoi 13.8 milionë euro. Manchester Unitedi i kishte shkarkuar edhe dy trajnerët e kaluar, para Mourinhos, David Moyes dhe Louis Van Gaal. Mirëpo, me trajnerët paraprakë, shkarkimi kishte ardhur vetëm kur kualifikimi në Ligën e Kampionëve ishte i pamundur, ndërsa Mourinho u shkarkua edhe më herët.

Trajneri i Real Madridit, Santiago Solari, ka sugjeruar se gazetarët kishin qenë mashtrues dhe të paqartë në mënyrën se si ia kishin bërë pyetjen për incidentin me kartonin e verdhë Sergio Ramosit. Ramosi do të mungojë në ndeshjen kthyes kundër Ajaxit, në fazën e 1/8 të finales së Ligës së Kampionëve, pasi u ndëshkua me karton të verdhë në fitoren kontroverze të Real Madridit me rezultat 2:1. Në ndeshjen e tij të 100-të për Real Madridin, spanjoli u ndëshkua me karton të verdhë

pak para fundit të ndeshjes, duke u siguruar kështu se do të mund të luajë në ndeshjet e çerekfinales, nëse arrijnë të kualifikohen nga kjo fazë. "Sa i përket asaj që e ka thënë Segio, ai i ka dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme dhe ai ka treguar qartë se kishte qenë duke folur për ndërhyrjen", ka thënë Solari në konferencën për shtyp. "Atij iu bë një pyetje e ndërlikuar, ju, gazetarët, i keni metodat e juaja. Sidoqoftë, ai ka sqaruar gjithçka", theksoi Solari. Pas ndeshjes, Ramosi kishte ngjal-

lur shumë debat, pasi që kishte thënë se e kishte bërë qëllimisht ndërhyrjen. "Duke e parë rezultatin e ndeshjes, do të gënjeja nëse do them se nuk e bëra qëllimisht [ndërhyrjen për t'u ndëshkuar]. Nuk e bëra për ta nënvlerësuar kundërshtarit ose pse mendova se e kemi siguruar kualifikimin, mirëpo në futboll duhet të marrësh vendime të vështira", ka thënë Ramosi. Megjithatë, spanjoli i ndryshoi fjalët e tij, vetëm disa orë më vonë, përmes një postimi në llogarinë e tij

në rrjetin social Twitter. Megjithatë, tani Ramosi ka thënë se ai ishte habitur nga i gjithë debati rreth deklaratave të tij, duke insistuar se ai kishte thënë që e kishte bërë me qëllim ndërhyrjen, mirëpo nuk e kishte bërë me qëllim për t'u ndëshkuar me karton të verdhë. "Jam i habitur nga e gjitha kjo. Unë desha të them se e bëra ndërhyrjen me qëllim, një ndërhyrje që ishte e paevitueshme, e jo që u ndëshkova qëllimisht me karton të verdhë", ka thënë Ramos për Marcan.



Zidane do të ulet në stolin e Chelseat

Britanikët e "The Sun" janë të bindur se aventura e Maurizio Sarrit te Chelsea nuk do të vazhdojë për sezonin e ardhshëm, teksa theksojnë se shkarkimi mund të vijë shumë më herët, ndoshta që në fund të muajit shkurt. Ata shkojnë edhe më tej, teksa raportojnë se blutë e Londrës kanë vendosur kontaktet me ish trajnerin e realit të Madridit, Zinedine Zidane, me të cilin duket se kanë arritur edhe një marrëveshje paraprake, që do të hyjë në fuqi këtë verë. E përditshmja britanike raporton gjithashtu se me Zidane, drejtuesit e Chelseat po bisedojnë edhe për merkaton, duke hedhur bazat e një skuadre konkurruese për sezonin e ardhshëm, teksa gjithçka do të fillojë nga bindja e Hazard për të mbetur në Londër. Gjithashtu, mendohet se me Zidane, në Londër mund të transferohet edhe Isco, ndërsa për sulmin do të synohet ish kapiteni i Interit, Mauro Icardi. Mbrojtja është një tjetër repart ku Chelsea pritet të ndërhyjë gjatë verës, veçanërisht në qendër të saj, ku shpëton vetëm Rudiger.

Lukaku "out", United ofron belgun në shkëmbim të një argjentinasi


Manchester United ofron sulmuesin belg Romelu Lukaku në shkëmbim të një sulmuesi argjentinasi. Drejtuesit e "djaive" do të përdorin sulmuesin 25-vjeçar belg për ta shkëmbyer në Serinë A, ku kanë piketuar dy sulmues që në këto momente janë në mes të polemikave: Mauro Icardi e Paulo Dybala. Lajmin e ka konfirmuar e përditshmja britanike "The Mirror", sipas së cilës Ole Gunnar Solskjaer nuk beson më tek Lukaku dhe synon ta largojë në fund të sezonit. Fillimisht ishte përfolur për një shkëmbim "kokë më kokë" me Paulo Dybala të Juventusit, por tashmë edhe një shkëmbim me Mauro Icardi është një hipotezë e mundshme. Edhe ky i fundit nuk po kalon një moment të mirë te skuadra



zikaltër, ndaj mund të ndodhë që të shkojë në Premier League sezonin tjetër. Kampionati anglez ofron më shumë parë dhe tërheq shumë sulmuesit argjentinasi, ndaj pas Higuain një tjetër amerikano-latin mund të transferohet nga Seria A në Premier. Mësohet

se United do të ofrojë Lukaku si te Juventusit ashtu dhe tek Interi, me shpresën që të bëjë një pazar të mirë. Ndërkohë që, të tri këta futbollistë janë thujtë në të njëjtën moshë dhe ndryshimi i ambientit mund t'u bënte mirë për të ardhmen.

Mbappe e refuzoi ofertën e Realit për shkak të Ronaldos



Kylian Mbappe e refuzoi ofertën për t'u transferuar në Real Madridit në vitin 2017, për shkak të Cristiano Ronaldos. Në vend të ma-

drilenëve, francezi e zgjodhi Paris Saint-Germainin. Pas paraqitjeve të tij mbresëlënëse në sezonin e tij të fundit me Monacon, Mbappe u bë lojtari më i kërkuar nga klubet e mëdha të Evropës. Real Madridi dhe PSG-ja ishin vetëm dy nga shumë klubet që bënë oferta mara-ramendëse për talentin e ri francez. Në fund ai vendosi të qëndronte në vendlindje dhe nënshkroi kontratë me PSG-në. Megjithatë, tani është bërë e ditur

se talenti i Monacos fillimisht kishte qenë afër arritjes së një marrëveshjeje me Real Madridit, mirëpo në fund e kishte refuzuar ofertën e tyre, për shkak të Ronaldos. Presidenti i klubit madrilen, Florentino Perez, dëshironte që Mbappe ta zëvendësonte superyllin portugez. Megjithatë, francezi nuk ndihej rehat me një sfidë të tillë, pasi që besonte se kjo krijonte shumë presion mbi të. "Mbappe në vend të Real Madridit, vendosi

që shkonte në PSG kur e kuptoi se Florentino Perez dëshironte që ai ta zëvendësonte Cristiano Ronaldo", shkruan gazetari i famshëm sportiv, Duncan Castles, në Daily Record. "Ti bashkohet klubit më të madh të botës, në një vend të ri, për një shumë rekorde, si zëvendësues i futbollistit më të mirë në planet... Kjo ishte një sfidë shumë e madhe dhe Mbappe dhe babai i tij nuk ishin të gatshëm ta pranojnë këtë ofertë".

“Këtu kam shpenzuar dy të tretat e karrierës time, kjo mes nesh është një histori e madhe dashurie dhe nuk dua të përfundoj”, u shpreh 35-vjeçari francez

RIBERY-BAYERN, “DASHURI” E PAFUNDME



Me lamtumirën e sigurt të Robben dhe Rafinhas, të dy në prag të skadencës së kontratave respektive, francezi Franck Ribery është i vendosur të arrijë rinovimin e kontratës aktuale me Bayernin e Mynihut, klub në të cilin impenjohet që 2007. “Këtu kam shpenzuar dy të tretat e karrierës time, kjo mes nesh është një histori e madhe dashurie dhe nuk dua të përfundoj”, u shpreh 35-vjeçari francez. Në të vërtetë, klubi gjerman është duke përjetuar një ndryshim brezash. Kampionët e Bundesligës janë të impenjuar në riorganizimin e organikës për sezonin e ardhshëm. Pas Robbenit dhe Rafinhas projektohen për t'u larguar edhe Hummels me Boateng. Por ai që nuk ka ndërmend të heqë dorë nga fanella e kampionëve të Gjermanisë dhe duke sfiduar edhe vitet është Ribery, që

kërkon më ngulm tashmë rinovimin e radhës, që nëse do të konkretizohet do të ishte i treti në tre vitet e fundit. “I jam shumë mirënjohës këtij klubi që më pranon pa kushte. Nuk do ta tradhetoja kurrë Bayernin, duke

zgjedhur një klub tjetër”, – deklaroi ai. Ribery në të vërtetë e ka treguar se pavarësisht viteve në kurriz është ende në gjendje të luajë në të tilla nivele. Muaji dhjetor u mbyll me një bilanc prej 4 golash në tre takime të Bundesligës. Ri-

bery mbërriti te Bayerni në vitin 2007 dhe përgjatë viteve duket se është shkrirë më klubin dhe tifozërinë. Polemikë nuk kanë munguar lidhur me emrin e tij, gjithsesi ai mbetet një prej ikonave të klubit gjerman.



Gareth Bale drejt Milanit

Milan nuk ka ndërmend të ndalet në merkato dhe gjatë verës mund të realizojë blerjen më të shtrenjtë të këtij viti. Sipas të përditshmes “Don Balon”, Leonardo dhe Maldini synojnë që të sjellin në “San Siro” sulmuesin uellsian Gareth Bale, që aktualisht aktivizohet me Real Madrid. Një strategji kjo për të rikthyer kuqezinjtë në elitë. Kuqezinjtë janë gati të ofrojnë 100 milionë euro për të marrë sulmuesin 29-vjeçar, duke formuar kështu një dyshe sulmi të frikshme bashkë me Piatek. Prej kohësh përflitet se Bale mund të largohet nga Madridi, por këtë herë duket se “lamtumira” është e paevitueshme dhe ky mund të jetë sezoni i tij i fundit në “Bernabeu”. Uellsiani nuk arriti të ketë një rol lideri te “los blancos” edhe tani që në ekip nuk është me Cristiano Ronaldo e kishte më shumë hapësira, ndaj nuk shihet më si titullar sezonin tjetër. Duket se drejtuesit e Real do t'i besojnë lojtarëve të rinj të blerë në merkato e janarit, duke hequr dorë nga Gareth Bale. Ndërsa kuqezinjtë shpresojnë të sigurojnë këtë transferim verën e ardhshme.



Princi i Arabisë do të blejë Unitedin për një shifër stratosferike

Princi i Arabisë Mohammad bin Salman shpreson të bëhet pronari i ri i Manchester United dhe është gati të ofrojë 4,4 miliardë euro. Ky lajm vjen pasi është raportuar më parë se drejtuesit e Man United janë duke kaluar shumë kohë në Arabinë Saudite. Tani princi saudit, familja e të cilit ka një pasuri rreth 900 miliardë euro, shpreson të bindë pronarët aktualë familjen Glazer ta shesë klu-

bin. Burime pranë Old Trafford gjithmonë kanë mohuar zërat se Glazer-at duan ta shesin, por oferta stratosferike mund të jetë e perefuzueshme. Familja amerikane bleu klubin për 900 milionë euro rreth 14 vite më parë, por e kanë rënduar me borxhe të mëdha. Mesa duket, regjimi i tyre mund të ketë një fund të lumtur, pasi janë pranë përfitimit të frikshmeve 2,5 miliardë euro.

Në Iran nuk transmetojnë ndeshjen e Bayern për shkak të një femre



Ndeshja e Bundesligës mes Augsburg dhe Bayern Mynih (fi-

tuar 3-2 nga bavarezët) luajtur të shtunën nuk është dhënë në me-



Sala përcillet për në banesën e fundit në Argjentinë

Ditën e shtunë është përcjell për në banesën e fundit futbollisti Emiliano Sala, që humbi jetën tragjikisht në një aksident ajror teksa po udhëtonte nga Franca për t'u bashkuar me ekipin e ri, Cardiff. Pothuajse një muaj ka kaluar nga data 21 janar kur u lajmë-

rua zhdukja e tij, por tashmë gjithçka është mbyllur, Sala nuk është më. Ceremonia u mbajt në një provincë të Argjentinës, Sante Fe, ku të pranishëm ishin 3000 persona, ndër ta prezentë ishin edhe trajneri i Cardiffit, Neil Warnock dhe shefi i klubit Ken Choo.

ORGANIZIMI I BOTËRORIT 2030, AMERIKA E JUGUT PËRBALLË EUROPËS

Viti 2030 do të jetë ai që do të shënojë plot një shekull nga lindja e Kupës së Botës, edicioni i parë i së cilës është zhvilluar në Uruguai, një nga vendet e kandidaturës. Hera e fundit që një botëror është caktuar në Amerikën Latine është edicioni i Brazilit në 2014




Për herë të parë në historinë e botërorëve të futbollit, një turne i përmasave të tilla mund të organizohet në 4 shtete të ndryshme. Kili iu bashkua kandidaturave të Argjentinës, Uruguait dhe Paraguait për të pritur evenimentin më të rëndësishëm të kombëtareve për edicionin e vitit 2030, duke shuar shanset e një triumfi të kontinentit

amerikano-jugor, tani në një format të ri. Presidenti i Kilit, Sebastian Pinera, përforcoi edhe më shumë projektin e lindur në vitin 2017. Politikani konservator, që në mandatin e dytë kërkon të bëjë hapa konkretë në rritjen ekonomike, e sheh Botërorin e futbollit si pjesë të platformës së tij. Viti 2030 do të jetë ai që do të shënojë plot një shekull

nga lindja e Kupës së Botës, edicioni i parë i së cilës është zhvilluar në Uruguai, një nga vendet e kandidaturës. Hera e fundit që një botëror është caktuar në Amerikën Latine është edicioni i Brazilit në 2014. Por, ky edicion duket se do të jetë ai i një lufte dhe lojës të kandidaturave të përbashkëta. Kundër vendeve amerikano-latine janë

Spanja, Portugalia dhe Maroku, një opsion transkontinental që ka gjetur opionencën e UEFA-s. Një kandidaturë të përbashkët mund të vendosin dhe Bullgaria, Serbia, Greqia e Rumania.



Federer: 10 vite më parë isha pranë tërheqjes nga sporti

Roger Federer, tenisti që ka fituar më shumë grand slam se çdo njeri tjetër, ka rrëfyer se një dekadë më parë ishte pranë tërheqjes nga sporti. Kjo gjë ndodhi kur ai fitoi grand slam nr.15 të karrierës së tij, në Wimbledon 2009. "Në vitin 2009, fitova fillimisht Roland Garros e më pas Wimbledon, moment kur theva rekordin e Pete Sampras. Kisha fituar gjithçka të mundshme në karrierën time dhe i bëra vetes një pyetje: A duhej të vazhdoja më të luaja? Por ishte një pyetje që i dhashë shpejt përgjigje, pasi vendosa të luaja sërish", u shpreh Roger Federer. "Jam i kënaqur që në karrierën time kam luajtur kaq shumë, kam fituar kaq shumë. Në jetë, çdo ditë është ndryshe nga ajo paraardhëse. Unë nuk jam vetëm një tenist, siç më shihni të gjithë, jam edhe një njeri normal si gjithë të tjerët: Një baba, një bashkëshort, një fëmijë për prindërit e mi", tha Federer.

Rosberg zgjedh kampionin e ri të botës, nxjerr nga gara Hamilton e Vettel

Nico Rosberg, ish-kampion bote në Formula 1, prej dy sezone shi tërhequr nga sporti, ka deklaruar se viti 2019 do të jetë viti i surprizave. Sipas tij, Lewis Hamilton dhe Sebastian Vettel duhet të kenë kujdes nga talentet e rinj që i janë afruar këtij sporti, që sipas Rosberg do të duelojnë për titull. Sipas pilotit gjerman, një prej tyre është Charles Leclerc, që këtë sezon do të pilotojë makinën Ferrari. "Do të paraqitet mjaft mirë me "kokëkuqen". Është shumë i shpejtë në pistë dhe këtë gjë do ta tregojë edhe me Ferrarin. Ai do të jetë kampioni i ri i botës dhe paralajmëron Hamilton e Vettel që të



ruhen pikërisht prej tij", u shpreh Nico Rosberg. "Vettel e ka të qartë që nuk ka më asnjë shans që të përsëritë gabimet e vitet të ka-

luar, pasi do të largohet me turp nga Ferrari. Edhe Hamilton nuk do ta ketë të lehtë, pasi Ferrari këtë vit e kërcënon realisht. Te

makina italiane nuk shoh vetëm një pilot kryesor si Vettel, por dy të tillë, pasi edhe Leclerc është një lider", tha Rosberg.

Rossi feston 40-vjetorin

Ikona e garave të motoçiklizmit, piloti italian Valentino Rossi, feston sot 40-vjetorin e lindjes. Njeriu i rekordeve në pistë, ka marrë urime të shumta sot nga të gjithë. Megjithatë, Rossi ka deklaruar se karriera e tij në pistat e Moto GP do të vijojë, pasi ai ka një sfidë të rëndësishme me veten: Të fitojë titullin e 10-të kampion në karrierën e tij. "Jam ende larg pensionit. Kam ende shumë dëshirë për të pilo-

tuar, ndaj e shoh shumë larg ditën që nuk do të garoj më", u shpreh Valentino Rossi, piloti më i dashur për fansat e motoçiklizmit. "Garat janë të rëndësishme për mua, por edhe familja tani ka rëndësinë e saj. Kur rritesh i kupton më mirë këto, ndaj bashkë me garat tani dua të kem edhe një familje", thotë Rossi. "Titulli i 10-të kampion në karrierën time është një ëndërr tek e cila besoj ende. Ndjej pak keqardhje që nuk e ka realizuar këtë



objektiv, pasi në dy raste jam mundur në garën e fundit. Mendoj se e kam merituar titullin e 10-të, ndaj

dhe vazhdoj ende të garoj, pasi e di që do t'ia arrij qëllimit një ditë", deklaroi Valentino Rossi.



Ende pa shkëlur mirë në Amerikë boksieri britanik Anthony Joshua ka vendosur rekordin e parë. Më 1 qershor,

Amerikanët mirëpresin Joshua

kampioni i botës në peshën e rëndë në kategoritë WBA, WBO dhe IBF do të mbrojtë titujt ndaj boksierit amerikan Jarrell Miller, duel që do të zhvillohet në "Madison Square Garden" të Nju Jorkut. Menjëherë sapo kanë dalë në shitje biletat për këtë duel, ato janë shitur. Madje brenda dy orësh, një rekord. Kjo tregon se fan-

sat amerikanë mezi presin të shohin në ringun e tyre boksierin e pamposhtur britanik. Meritë në këtë shitje ka edhe fakti se Joshua do të duelojë ndaj një nju-jorkezi si Miller, që ka lindur dhe jeton në Brooklyn. Çmimi i biletave shkonte nga 100 dollarë deri në 2500 dollarë për vendet afër ringut, çka pritet të gjenerojë një

shumë të konsiderueshme para-sh nga shitja e tyre. "Ne e prisim këtë shitje të shpejtë të biletave, pasi Joshua është një boksier që tërheq shumë fansa e sponsor. Duelojmë në një stadium mitik si MSG dhe premtojmë një duel të jashtëzakonshëm më 1 qershor", tha Eddie Hearn, menaxheri i Joshua.



Kujdesuni që Kombi juaj të rritet nëpërmjet fesë katolike, por mos persekutoni asnjëri që ta ndjekë atë me detyrim. Dielli, që është shëmbëllimi i Perëndisë, shkëlqen pa dallim për turkun ashtu edhe për të krishterin. Kushdo që këshillon për të luftuar për hir të Perëndisë, është një mashtrues i cili dëshiron të sakrifikojë të vërtetën për interesat e tij. Zoti është i fuqishëm, ai mund të bëjë gjithçka vetë, pa ndihmën e askujt...

Fjalimi i më poshtëm është marrë nga libri i autorit Stephan Zannowich, me titullin "Le Grand Castriotto d'Albanie, Histoire". Teksti prej 131 faqesh është botuar në vitin 1779 nga shtëpia botuese J.J. Kesler, Frankfurt. Gjergj Kastrioti, i sëmurë, nuk mund ti shmangej vdekjes dhe për këtë arsye fton në vatrën e tij princat, ambasadorët, gjeneralët, dhe drejtuesit kryesorë të vendit që tu lë amanetet e fundit ashtu siç i ka hije një luftëtari të madh. Para se heroi ynë të fillonte fjalimin, urdhëron që djali i tij i vetëm, Gjoni, asokohe dhjetë vjeç, të ndodhej mes të ftuarve. Fjalimin e Princit të Matit dhe mbretit të shqiptarëve e gjejmë në faqet 70–89 të librit, i shkruar në gjuhën frënge. Sipas autorit të veprës, ja si është shprehur Gjergj Kastrioti :

"Jam në prag të varrit. Po ju lë një mbretëri me forca të afta për ta mbrojtur, por me një pasardhës të paaftë nga mosha për ta drejtuar. Megjithatë, në qoftë se në të ardhmen ju bëheni trima dhe të vërtetshëm, ju mund të përballoni të gjitha sulmet e armiqve tuaj. Nuk është sipërfaqja e vendit ajo që bën një fron të respektueshëm, por aftësia e atij që ulet mbi të. Në qoftë se ju jeni i djallëzuar, shërbëtor i ministrave tuaj, dhe naiv i lajkave të oborrtarëve tuaj, atëherë asgjë nuk do të jetë më e lehtë sesa përmbysja nga maja më e lartë ku ju ndodhëni. Duhet të jetë virtyti themel i fronit. Virtyti nuk është fantazi. Ndoshta do ju a thonë një

FJALIMI I FUNDIT MADHËSHTOR I GJERGJ KASTRIOTIT

DIELLI SHKËLQEN PËR TURKUN ASHTU EDHE PËR TË KRISHTERIN



ditë, por mos harroni se ai që do ju a thotë, është një tradhtar, një dinak, që për të mbretëruar në vendin tuaj, do ju sugjerojë maksimum të rreme, të cilat herët a vonë do të shkaktojnë përmbysjen tuaj. Duke pasur virtytin si udhërrëfyes, lajkatarët dhe të pabesët do të largohen prej jush...Të vërtetshëm, ju mund të mbani lehtë perandorinë që po ju lë të tronditur nga lufta e vazhdueshme ; ta përforconi, ta rimëkëmbni nëpërmjet pushimit dhe qetësisë...

Nëse ushtari apo kleriku janë mashtrues dhe të padrejtë, atëherë varini në shtyllë

Krijoni vendshkrime të paçensuruara në të gjithë sipërfaqen e mbretërisë ku mund të publikohen të gjitha padrejtësitë dhe dhuna që mund të ushtrohen nga drejtuesit e krahinave tuaja. Bëni këtë edhe për miqtë apo familjarët e

tyre që jetojnë në oborrit tuaj, të cilët i fshehin këto shkelje apo i përdorin nën pretekstin e drejtësisë dhe të domosdoshmërisë. Shqyrtoni gjithçka nga ju vetë, dhe nëse magistrati, ushtari apo kleriku janë mashtrues dhe të padrejtë, atëherë pa mëshirë varini në shtyllë në vendin e kimit : ju do të vini re se pasardhësi i tij do të bëhet i drejtë dhe i njerëzishëm...Kursapo të keni marrë drejtimin e pushtetit, ju do të kujdeseni për Drejtësinë, e cila është themeli i të gjitha virtyteve. Ju do të mbronni artizanët, si njerëzit më të dobishëm të zonave të pushtetit tuaj, dhe do të parandaloni shtypjen e tyre nga pasanikët. Krenaria dhe luksi i bën pasanikët të pandjeshëm ndaj fatkeqësive të varfërve, të cilët nuk kanë as tituj (grada) e as mbështetje. Duhet të jeni të butë dhe të dashur me

njerëzit tuaj ; dukuni shpesh mes tyre, bisedoni me ta, pyesni ata nëse dëshirat tuaja për drejtësi janë ekzekutuar nga ministrat tuaj. Princi që qëndron i mbyllur me oborrtarët e tij shikohet nga populli i tij si armik dhe tiran...Dëgjoni ankesat dhe kërkesat e popullit tuaj me qetësi sa që ti frymëzoni besim atij për t'ju ndihmuar të korrigjoni abuzimet dhe fatkeqësitë e shtetit.

DIELLI SHKËLQEN PA DALLIM PËR TURKUN ASHTU EDHE PËR TË KRISHTERIN

Kujdesuni që Kombi juaj të rritet nëpërmjet fesë katolike, por mos persekutoni asnjëri që ta ndjekë atë me detyrim. Dielli, që është shëmbëllimi i Perëndisë, shkëlqen pa dallim për turkun ashtu edhe për të krishterin. Kushdo që këshillon për të luftuar për hir të

Perëndisë, është një mashtrues i cili dëshiron të sakrifikojë të vërtetën për interesat e tij. Zoti është i fuqishëm, ai mund të bëjë gjithçka vetë, pa ndihmën e askujt... Në qoftë se fati ju bën endacak, të varfër apo nevojtar kurrë mos e ndryshoni fenë për interes... Mbyllini që në origjinë mosmarrëveshjet e teologëve dhe hipokritëve, të cilat janë më të rrezikshmet për lumturinë e një shteti. Kemi parë perandoritë më të lulëzuara të përçahen dhe të tronditen nga këta fanatikë... Shihni Perandorinë e Konstandinit të rrënuar nga Muhamedi, dhe princin Jean Paléologue (Gjon Paleologu) i shkelur nga kuajt e Arabëve. Ai ishte supersticioz, priftërinjtë e tij ambiciozë dhe injorantë, oborrtarët e tij të rremë dhe të shthurur nga luksi, dhe tani princi, priftërinjtë dhe oborrtarët kanë vdekur dhe po vdesin në skllavëri.

Nëse keni fat të mjaftueshëm për të pasur filozofë në vendqeverisjet tuaja, të cilët janë të ndriçuar nga drita e arsyes dhe jo nga sistemet e rreme, le të shkruajnë në paqe dhe të reagojnë ndaj paragjytimeve dhe makinacioneve të kujtdo që flet në emër të Zotit me qëllim për të heshtur mbretin dhe drejtësinë. Ju do t'i mbronni ata kundra zellit të tepruar të drejtuesve hipokritë duke i shpërblyer me vende pune në gjykatat dhe oborret tuaja.

Kur të ju flasin keq për dikë, ju do ta dëgjoni me gjysëm veshi... Ju do të jeni të sjellshëm me të gjithë shtetasit popullore. Si arsye e dallimit të gradës që do të keni së shpejti në shoqëri, ju duhet të dalloheni nga të tjerët nëpërmjet bujarisë, i cili është karakteri dal-



lues i princave. Një monark, edhe i varfër, duhet të jetë bujar...

Mbroni meritën dhe shpërblejeni atë kudo që ajo ndodhet. Mirësia duhet të shoqërohet me një zemër bujare. Njeriu ndërton tempuj, ngre altarë për Zotin falë mirësisë së tij. Evitoni për gjithmonë shekullit, rrethit dhe racës tuaj turpin për të pasur njerëz të dëshpëruar nga mizoria, krenaria apo injoranca juaj. Mos harroni se njeriu lind për lumturinë e njëritjetrit...

MOS PËRBUZNI ASKËND

Armatosuni nga guximi dhe vendosmëria në mjerim, me maturi në mirëqenie. Mos u zhytuni në përtaci, ajo është nëna e të gjitha veseve...Mos mbyllni sytë ndaj fqinjëve dhe traktateve të tyre: ata do të presin momentin kur ju do të jeni të brishtë për t'ju akuzuar dhe do të pohojnë pretendime të rreme mbi trashëgiminë që po ju lë. Mos përdorni spiunë për të ditur se çfarë thonë njerëzit në lidhje me administrimin tuaj. Bëni punën tuaj ashtu si duhet, njerëzia le të flasin dhe të shkruajë çfarë të dëshirojnë... Ti jepet mundësia gjithsecilit prej rrethit tuaj që të ju shkruajë; Ju do të punësoni sekretarët tuaj që të përgjigjen për çështje të ndryshme ose publike, por sekretet e shtetit duhen të mbeten mes jush...

Mos përbuzni askënd - më i vogli dhe më i varfëri mund të ju rrëzojë, ashtu si dhe mund të ju ndihmojë me këshillat dhe kurajon e tij. Jeni të durueshëm në çështjet e luftës, të patrembur në rreziqe, të butë dhe humanë, kurrë mizorë dhe gjaknxehtë. Fshihni dhimbjen që fatkeqësitë tuaja mund të ju shkaktojnë. Armiqtë tuaj do të jenë gjithmonë të gatshëm të ju fyejnë për fatkeqësitë, dhe ministrat të ju tradhtojnë. Ftoni mes jush të huaj të arsimuar duke u dhënë një rol këshilltari edhe në rast kur ata nuk janë fisnikë e të pasur. Kompetencat që i akordohen fisnikërisë janë prodhim i politikës. Ju mund të përdorni fisnikët si të dëshironi. Pasanikët injorantë do t'i lehdhoni, kështu do të kurseni pasurinë tuaj për mirëmbajtjen e ushtrisë, dhe do të keni një oborr të shkëlqyeshëm falë krenarëve por dhe budallenjve, që nuk kanë asnjë lloj virtyti përveçse floririt.

Mos jeni të ndrojtur ndaj ndjenjave tuaja. Deklaroni haptazi oborrtarëve tuaj, se ai që do të ju gënjejë dhe do të ju dërgojë në rrugën e gabuar në administrim, pa asnjë falje do të varet në shtyllë. Poetëve që do të ju thurin vargje, për të ju bindur se jeni më i madhi, më bujari, më i mrekullueshmi, luftëtari më i madh ndër të gjithë mbretërit, u dërgoni në këmbim një copë letër, bojë dhe një pendë nga një oborrtar i panjohur, me urdhrin për të dëshmuar të vërtetën e asaj që shkruajnë, dhe në qoftë se nuk mund të bëjnë një gjë të tillë, të kufizojnë veten në dhënien e këshillave, duke u lënë të kuptohet se nëse



vazhdojnë të shkruajnë marrëzira të tilla të rrezikshme, ata do të mbyten nga vetë ju si person i shenjtë i të vërtetës.

Kujdesuni që të keni gjithmonë ushtarë të mirë dhe të disiplinuar; që ushtarët tuaj të mos bëhen përtacë, ti stërvitni dhe ti trajtoni jo si skllëvër por si shokët tuaj. Kur të jeni në luftë, ju do të udhëheqni ushtrinë si gjeneral dhe në betejë do të luftoni si ushtar. Emri i mbretit është një titull shumë i nderuar, por ky titull ka peshë të madhe dhe detyra të vështira për të realizuar. Kryesorja është të pranohesh dhe të respektohesh në rrethin tënd. Zoti nuk ka dhënë fuqinë supreme për të na zhytur në qullësi, për që të jemi mbrojtës të çështjes publike. Për një zemër të butë dhe një shpirt të virtytshëm, mirëqenia e përgjithshme e popullit tënd është kënaqësia më e madhe që mund të përjetohet. Neglizhenca dhe një lloj mirësie që e thërrasin "mendjelehtësia e një princi", u shkaktojnë dëme njerëzve; dhe ju e dini se roli i mbretit është t'i mbrojtë

NJË PRINC ËSHTË GJITHMONË I PASUR, KUR AI ËSHTË I MENÇUR

Dëboni larg jush astrologët gjykatës dhe kimistët prodhues ari dhe diamantesh. Një princ është gjithmonë i pasur, kur ai është i mençur dhe i lartësuar shpirtërisht. Emri juaj do të jetë i shkruar në një pllakë prej mermeri të bardhë me shkronja të zeza mbi dyert e kështjellave tuaja të destinuara për të burgosurit. Mjerim për guvernatorin që i veshu mbretit pajfësinë, që përkeqësoi nga kopracia dhe zelli i tij dënimin e fajtorëve... Mbroni njerëzit e dashur dhe të mirë, ndëshkoni shpirtat e këqij. Jeni të ndjeshëm ndaj lëndimit, por akoma dhe më shumë ndaj shërbimit të popullit tuaj dhe miqësisë të njerëzve të ngjashëm me ju. Pika kulmore e një lufte është çorientuese, duhet ndërjer pasiguria (rreziku). Atëherë kujdesi dhe guximi do të ju shërbejnë më mirë se sa pasuria. Duhet të dish të fitosh, por mos harroni se edhe mund të mposhtesh. Sfidoni veten tuaj: mos e humbisni toruan nga zemërimi,

Në qoftë se Papa përpiqet të rrisë numrin e priftërinjve dhe murgjve për të nxjerrë para nga krahinat tuaja...ose ju nxit që të hapni luftëra në emër të Zotit, rrufeja hakmarrëse qëlluftë mbi ju dhe pasardhësit tuaj në rast pranimit. Papët nuk kanë arritur kurrë të manipulojnë një ushtar të vjetër si unë, por nuk do të hezitojnë të bëjnë një gjë të tillë ndaj jush si arsye e moshës së re dhe mungesës së eksperiencës për të qeverisur, për të shërbyer. Roma është fodulle vetëm me princat e dështuar. Roma, duke më pasur frikë, më ka bërë gjithmonë lajka

sepse atëherë i thjeshti bëhet i keq dhe mbreti një përbindësh...

Mos harroni se politika turke është për të mbjellë përçarje mes princave të krishterë; e gjithë madhështia e tyre gjendet në këtë politikë të shkëlqyeshme, e cila bën me shumë pushtime sesa armët e tyre. Së fundi, në qoftë se jeni xheloz se po ju lë një trashëgimtar që ju pengon për të marrë fronin, mos harroni se kam qenë babai juaj, dhe shpatën do e përdorni vetëm për të rrëzuar armikun.

PAPËT NUK KANË ARRITUR KURRË TË MANIPULOJNË NJË USHTAR TË VJETËR SI UNË

Ju do të keni lidhje të shumta me oborrrin e Romës, që unë kam qenë deri tani mbështetës dhe mbrojtës. Interesat e mia më kanë detyruar të përshtat politikën time me të sajën. Rrethanat në të cilat jam gjetur veten nuk më kanë lejuar të luftoj uzurpimet turke dhe pretendimet e papës. Për të mirën e krahinave të mia kam qenë gjithmonë i lumtur me

veprimet që kam ndërmarrë. Roma është fodulle vetëm me princat e dështuar. Roma, duke më pasur frikë, më ka bërë gjithmonë lajka. Ajo ndryshon maksimumat dhe pozicionet sipas rasteve, por frika se humb tokat e saj ndaj sulmeve të Muhamedit, e ka detyruar atë të qëndrojë modeste ndaj meje, duke më njohur të gjitha të drejtat, titujt, dhe zotërimet e realizuara gjatë betejave të mia. Papët nuk kanë arritur kurrë të manipulojnë një ushtar të vjetër si unë, por nuk do të hezitojnë të bëjnë një gjë të tillë ndaj jush si arsye e moshës së re dhe mungesës së eksperiencës për të qeverisur, për të shërbyer. Mos harroni, se me praktikata e shumta që ata përdorin për të arritur qëllimet e tyre, më e forta, është rrëfimi. Por është e lehtë ta kuptoni: kur prifti do të dojë të dijë më shumë sesa mëkatet tuaja, kthejeni si një mashtrues në vendin e tij, dhe dënojeni si të tillë, që të shërbejë si shembull për pasardhësin e tij.

Megjithatë, është shumë e rrezikshme të kundërshtosh hapur Papën, këtë idhull të madh të fesë sonë. Ai është një njeri si të tjerët, me pasionet dhe dobësitë e tij... Nëse Papa ju dërgon faljet, reliket, bekimet, merrni ato me respekt, dhe i nderoni me njerëzit tuaj duke e dhënë ju shembullin kryesor... Por në qoftë se Papa përpiqet të rrisë numrin e priftërinjve dhe murgjve për të nxjerrë para nga krahinat tuaja...ose ju nxit që të hapni luftëra në emër të Zotit, rrufeja hakmarrëse qëlluftë mbi ju dhe pasardhësit tuaj në rast pranimit. Zoti hakmerret ndaj fyesve të tij, pra nuk ka nevojë për ndihmën e njeriut. Mos kërcënoni Romën, kur ajo nuk ju kërcënon. Por shpallni luftë ndaj kujt do që mundohet të prishë harenë e popullit, dhe legjitimitetin e fronit.

Ju do të ndaloni çdo banor i cili ndodhet nën qeverisjen tuaj, që të mos bëhet as prift e as murg pa arritur moshën dyzet vjeçare. Për t'u ushqyer nga puna e të tjerëve, duhet më parë që njeriu (mashkulli) të ketë kontribuar në mbështetjen e komunitetit, prej të cilit dëshiron të ndahet për të shijuar jetën e tij... Këta priftërinj dhe murgj duhet të ju ndihmojnë të mbroni kombin në kohë lufte, sepse në kohë paqeje po ky komb i ushqen pa i përdorur. Nëse Papa kundërshton, bindeni atë me butësi, dhe vetëm në qoftë se është e nevojshme përdorni shpatën...

Një politikë e tillë do të ju pajtojë me dashurinë atërore të pasardhësve të tij, dhe do të bëheni shembull dhe lider për të gjithë mbretërit, të cilët frikacakë, të dobët, injorantë, budallenj, u uzurpohet nga Papa dhe ministrat e tyre, fuqia që Zoti u ka dhënë për të përhapur lumturinë e Kombeve, ku ata duhet të jenë zotëritë dhe etërit".

(Përkthet nga frëngjishtja: Aurenc Bebja, Francë)





LARGONI SËMUNDJET E MUSHKËRIVE ME TRAJTIME POPULLORE

Fërkimi i gjoksit dhe kurrizit me përzierjen e 1 filxhan vaj ulliri me 1 lugë kafeje me spec djegës të bërë pluhur dhe 1-2 lugë gjelle uthull. Fërkimi bëhet në dhomë të ngrohtë ose pranë zjarrit, derisa të fillojë djersitja. Pas kësaj, gjoksi dhe kurrizi mbështillet me lesh deleje të palarë

Mahisja e cipave të mushkërive quhet pleurit. Pleuriti është një sëmundje serioze që jep shenja lokale, por gjithashtu edhe në tërë organizmin. Fillon menjëherë me dhimbjen e fortë të gjoksit që pengon frymëmarrjen e thellë, me kollë të thatë, me temperaturë, humbje të oreksit dhe dobësi të përgjithshme.

Në qoftë se nuk mjekohet shpejt, ka mundësi të kthehet në pleurit me ujë, që është një sëmundje mjaft e rëndë e cila në 90% të rasteve shkaktohet nga mikrobi i tuberkulozit. Në këto raste midis 2 cipave të mushkërive grumbullohet ujë që mund të arrijë deri në 2 litra. Atëherë sëmundja fillon me ngritje të lartë të temperaturës, 39-40 gradë celsius dhe dhimbje të forta të gjoksit. Me

kollë të fortë, të thatë e të mundimshme, i sëmuri ndjen dobësi të madhe, lodhet shpejt, nuk ka oreks, ka vështirësi në frymëmarrje, një ndjenjë rëndimi në kraharor dhe një gjendje jo të mirë të përgjithshme të trupit.

Gjatë sëmundjes këshillohen ushtrime të lehta gjimnastike, frymëmarrje të thellë që lehtëson tendosjen e mushkërive të shtypura. Kjo sëmundje shkakton rrahje të forta të zemrës, mavijosje të buzëve, zbehje të lëkurës. Mungesë të oreksit, ka pulse të shpejta dhe ulje të tensionit. Duhet të bëni vizitë të herë pas hershme tek mjeku kompetent.

TRAJTIME POPULLORE. Që në kohërat e lashta është përdorur për sëmundjet e mushkërive leshi i palarë i deles, sepse ai thithte

djersën e trupit që çliroheshin nga ftohja dhe e mbante trupin e ngrohtë, ndërkohë që përthante gradualisht sëmundjen, pasi yndyrat që përmban vetë leshi janë shumë të efektshme për ftohjen. Fërkimi i gjoksit dhe kurrizit me përzierjen e 1 filxhan vaj ulliri me 1 lugë kafeje me spec djegës të bërë pluhur dhe 1-2 lugë gjelle uthull. Fërkimi bëhet në dhomë të ngrohtë ose pranë zjarrit, derisa të fillojë djersitja. Pas kësaj, gjoksi dhe kurrizi mbështillet me lesh deleje të palarë.

Merni krunde gruri dhe i lini derisa të zbuten mirë dhe tharohen duke i përzier çdo ditë. Kur uji ku kemi hedhur krundet është thartuar si birra, pimë prej tij 1 gotë në ditë. Kjo recetë iu shërben sidomos të sëmurëve me plagë në

mushkëri, për t'u pakësuar dhimbjen dhe për t'ua qetësuar ato. Lulet e manushaqes ose kërcelli vlejné për sëmundjet e ftohjes dhe pezmatimin e mushkërive, bronket, astmën e lagur, kollën e bardhë. Përdoret si çaj dhe shurup për fëmijët e vegjël. Merni 5 lugë me lule ose gjethe me kërcell. I zieni në 500 ml ujë për 10-15 minuta dhe i pini 2 herë nga 1 gotë para buke.

Merni 30 gramë lule ose gjethe të mëllagës së bardhë, lule trëndafili dhe 10 gramë vjollca trengjyrëshe. Merni 4 lugë nga përzierja dhe i zieni me 200 ml ujë të porsazaluar. Ena mbulohet me kapak që të ftohet pak. Pasi kullohet, pihet e vakët 4 herë në ditë, duke e ëmbëlsuar me pak mjaltë. Mjekimi vazhdon 5-6 ditë.



30 minuta ushtrime "shkatërrojnë" tetë orë ulur

Qëndrimi çdo ditë ulur nuk është i mirë për shëndetin tonë, por shumë pak njerëz janë të vetëdijshëm për rrezikun që shkakton ai dhe se si kjo mund të shmanget shumë lehtë. Studimi i fundit tregon se madje edhe pak kalori të djegura nga aktivitetet mund të ndikojnë me të madhe në përmirësimin e gjendjes shëndetësore.

Vetëm gjysmë ore aktivitet fizik ditor mund të "shkatërrojë" një ditë qëndrimi ulur në zyre, tregon studimi i Universitetit Kolumbia, në të cilin morën pjesë 7.999 persona të moshës mbi 45-vjeç gjatë periudhës së monitorimit të aktivitetit të tyre ndërmjet viteve 2009 deri 2013.

Gjatë monitorimit është regjistruar sasia dhe intensiteti i aktivitetit fizik dhe është përcjellë shkalla e vdekshmërisë dhe rreziqeve shëndetësore.

Sipas këtij studimi, 30 minuta ushtrime në ditë ulin rrezikun e vdekjes së parakohshme për 17 për qind. Nëse pjesëmarrësit do të praktikonin vrapimin pse biçikletat, rreziku nga vdekja e parakohshme do të ullej për 35 për qind. Mos e humbni besimin në veten tuaj, bëni ndryshime të vogla, shënoni çdo sukses dhe mos hiqni kurrë dorë, pasi çdo hap llogaritet.



Televizori ndikon në peshën e fëmijëve

Qëndrimi para televizorit është një nga rreziqet për obezitetin tek fëmijët. Sipas studimit, fëmijët që luajnë video lojëra, ushqehen apo janë pranë kompjuterit, kanë më shumë ndikim në peshën e tyre sesa kohëzgjatja e periudhës sa qëndrojnë ulur. Për këtë arsye, studiuesit argumentojnë se duhet të ndryshohet në mënyrë urgjente sjel-

lja e fëmijëve që nuk janë aktivë, përpara se të jetë vonë. Një në pesë fëmijë në Britani të Madhe, që fillon shkollën për herë të parë është mbipeshë. Ndërsa një në pesë persona të moshës 6-19 vjeç janë mbipeshë në SHBA. Në Australi shifrat janë më të larta, ku pothuajse një e katërta e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç konsiderohen mbipeshë.

Simptomat më pak të njohura të metabolizmit të ngadalësuar

Metabolizmi përbën grupin e proceseve kimike të cilat ndikojnë në aftësinë e trupit për t'i shndërruar yndyrat, sheqernat dhe proteinat në energji. Shumë njerëz kanë probleme të mëdha metabolike, veçanërisht gjatë dimrit kur të gjithë merren më pak me aktivitete sportive dhe të ngjashme. Metabolizmi i shpejtë prodhon energji në mënyrë efikase, ndërsa metabolizmi i ngadalësuar pothuajse nuk e bën fare këtë—gjë

që rezulton në akumulimin e kalorive.

Përveç simptomave të zakonshme, ekzistojnë edhe simptoma atipike të metabolizmit të ngadalësuar. Në listën e simptomave tipike përfshihen: mbipeshja, mungesa e libidos (dëshirës seksuale), marramendja, dridhjet, frymëmarrja e shkurtuar, ngërçet, plogështi e muskujve, sy të thatë dhe ngjirja e zërit. Simptomat atipike janë: këmbët dhe duart e ftohta,

pagjumësia, ngadalësimi i lëvizjeve, të folurit dhe të menduarit, ndjesia e therjes në duar dhe këmbë, lëkura e thatë, vështirësi me gëlltitje, humbje e oreksit, dhimbje koke, rënie e flokëve dhe qimeve të trupit, dhimbje e muskujve dhe dhimbje e nyjave, kapsllëku dhe imuniteti i dobësuar.

Nëse dëshironi ta përshpejtoni metabolizmin, përqendrohuni që ta eliminoni stresin në mënyrë të ndryshme, përpunoni ta stabilizoni



orarin e gjumit dhe të merni lëngje të mjaftueshme në organizëm. Rekomandohet gjithashtu të ushtroni çdo ditë dhe ta rrisni

masën e muskujve, këshillojnë ekspertët. Përveç kësaj, konsumoni sa më shumë proteina dhe çaj të gjelbër si dhe ushqime me erëza.

DASHI 21. mars - 20. prill

Pozicionimi i Hënës do ketë ndikim goxha pozitiv tek jeta juaj ne çift sot. Do jeni shumë më tolerantë dhe më pak kërkues se kohët e fundit. Beqaret do kenë shume pretendime dhe nuk do arrijnë dot te gjejnë një person qe t'ua përmbushë te gjitha kushtet. Financat mund te marrin një drejtim tjetër shume me te mire nga me pare. Do ndihen shume te kënaqur dhe te qete.

DEMI 21. prill - 21. maj

Ka rrezik qe nen ndikimin jo te mire te yjeve te jeni acruet gjate kësaj dite dhe te bëni gabime te njëpasnjëshme. Partneri here do duroje, por here do tregohet vërtet i ashpër. Beqaret duan vërtet ta stabilizojnë jetën e tyre, por rrethanat nuk do jene te favorshme. Ne planin financiar ekuilibri do te priset dhe do gjendeni shpesh ne situata goxha delikate.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Do kaloni momente fantastike gjate kësaj dite pranë personit qe dashuron dhe do doni qe dita te mos ketë fund. Shpesh do ndihen si ne ëndërr. Beqaret do ëndërrojnë me shume nga sa duhet dhe realiteti do ju duket paksa i hidhur. Gjendja e financave do jete me e mire, por kjo nuk do te thotë qe ju te kryeni shpenzime te pamenduara te cilat mund t'ua tronditin situatën.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Nuk do e keni shume te lehte te pranoni çdo gjë qe do ju kërkohet partneri gjate kësaj dite dhe mundet edhe te konfliktoheni me te. Nëse nuk doni qe gjerat te marrin vërtet tatëpjetën me mire merrni masa dhe flisni hapur për gjithçka. Beqaret do jene me te disponueshëm për ta gjetur gurin e çmuar dhe mund te kenë disa njohje. Ne planin financiar çdo gjë ka për te ecur mire.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Marrëdhënia juaj ne çift nuk ka për te qene shume e mire sot. Do jeni te pandërgjegjshëm për hapat qe do hidhni dhe nuk do e kuptoni as kur te gaboni. Beqaret do kenë një dite shume me ndryshe nga me pare dhe do përjetojnë emocione me te veçanta. Me shpenzimet duhet te jeni pak me te kursyer sepse po u nixtuat mund te bëni gabime me pasoja për te ardhmen.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Do keni me shume se kurrë besim tek partneri juaj sot dhe marrëdhënia me te do jete shume me e ngrohte. Do i zgjidhni edhe disa probleme te se shkuarës. Beqaret do kenë probleme serioze nëse hidhen ne krahët e te panjohurve. Fatmirësisht financat do jene te bekuara dhe do mund te kryeni te gjitha shpenzimet e nevojshme. Disa mund te heqin edhe disa para mënjani.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Edhe pse situata ne jetën tuaj ne çift do përmirësohet sot, serish nuk do jeni plotësisht te qete pranë atij qe dashuron. Përjetimet negative te se shkuarës do ju lënë hije dyshimi. Beqaret duhet te reflektojnë me shume kujdes para se te hedhin çdo lloj hapi ne mënyrë qe nesër te mos vuajnë. Situata financiare do jete tejet e ndërlikuar. Kujdes me çdo hap.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Dite e paqëndrueshme kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Here pas here do keni edhe debate te forta me partnerin dhe do mendoni një ndarje. Beqaret do realizojnë disa takime dhe njeri nga personat do ju pëlqejë tej mase. Mos prisni shume qe te hidhni hapa. Gjendja e financave do jete goxha konfuze. Nuk do arrini dot te kryeni as shpenzimet me te nevojshme.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do kaloni momente te vështira sot ju te dashuarit dhe asgjë nuk ka për te ecur si e kishit ëndërruar. Me mire qëndroni pak larg njeri-tjetrit. Beqaret nuk duhet te hidhen menjëherë ne krahët e dikujt qe i josh sepse mund te lëndohen dhe mund te zhgënjehen tej mase. Ne planin financiar tregohuni sa me te arsyeshëm nëse nuk doni te keni probleme e vështirësi.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Mund te bëni edhe ndonjë çmenduri te vogël gjate kësaj dite vetëm për ta ndryshuar rutinën e jetës suaj ne çift. Partnerin do e keni gjate gjithë kohës pranë dhe do bashkëpunoni për çdo gjë. Beqaret nuk duhet te humbin kohen kot, por duhet t'ia shprehin sa me pare ndjenjat dikujt qe pëlqejnë. Ne planin financiar do mbizotërojnë gjithë kohës ekuilibri. Do ndihen te qete.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Dite shume e qete dhe e ngrohte kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Ne krahët e partnerit do përjetoni emocione te mëdha si kurrë me pare. Beqaret nuk do e kenë aspak mendjen tek krijimi i një lidhjeje sepse ka çështje te tjera shume me te rëndësishme për ta. Ne planin financiar nuk do dilni lehtësisht nga gjendja problematike.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do jeni me te vendosur se kurrë t'i zgjidhni mosmarrëveshjet qe ju kane dale ne jetën tuaj ne çift sot dhe do ndihen me te qete. Mbrëmja do jete tejet emocionuese. Beqaret do kenë takime fantastike te cilat do ua ndryshojnë menjëherë jetën. Nëse tregoheni te pamatur me shpenzimet gjendja e financave do vije duke u përqendruar. Tregohuni me te kujdesshëm.



NE KETE DATE

18 SHKURT 1932
13 PRILL 2018

KOHA	QË KA PËSUAR RENIE SHPIRTERORE	ISH FUTBOLLISTI NIGERIAN, AKINBUJ	AKTORI KOSOVAR, PALLASKA	KOHA	FUTBOLLISTI SPANJOLL, EL HADADI				
MASHKULLI IDELES				TËRËSIA E ARAVE TË MBJELLA ME MISER					
QYTET NË INDI				MARGARITAR			HEALTHCARE IDENTIFICATION NUMBER		
GRUAJA E ODISEUT (PASHQ.)							POETI ITALIAN, FRANÇESKO		
RUMANIA		IRIDIUMI			GËZIM I MADH, NGAZELLIM			ITALIA	
		LËSHOJ ZË TË FUQISHËM			PLAK ME PERVOJË			BËJ GJUMË TË SHKURTË, DREMKE	ISH FUTBOLLISTI ITALIAN, DE OLIVEIRA
PËRKUL			BETEJË (SH. PASHQ.)						
			PASKALI						
QË TREGON SHKALLËN ME TË LARTE NË KRAHASIM ME TË TJERËT								ESAD MEKULI	
								ZANORE TË NJEJTA	
REGJISOR I QOSJA				TRONDITJE E FORTE SHPIRTERORE					
				NGORDH					
VELI KARAHODA					GËSHTENJA E QËRUAR				
					NEGACION I HUAJ				
KOHA	VEHJIE ESKIMEZE							FLORI	
	SUEDIA							AZOTI	
MATERIAL PËR PANTALLONA									QYTET NË FRANCË

ZGJIDHJET: V, ANJES, MEZA, ARAN, DI, T, EURO, MUNIR, DASH, MISËRI, EDAPAL, HIN, PENELOPE, I, R, IR, SHEND, EP, LUFTËRA, SIPËROR, EM, ISA, TRAUMA, VK, CAMRUKU, ANORAK, AR, STOF, NANTI.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

		5	2			7				4		3	1			5		2
3									6	7				2				4
	2	7		4		3	1					9		6		3		
	5			6	8		9			9		2				4		5
			4		2													
7		3	5	9		2		4			6							9
	7	2		8		6	3					4		3		7		
9								2		6				5				8
		1			3	4				8		5			7	1		6

Shumë i lehtë: 195236748, 348157926, 627849315, 254368197, 819472563, 763591284, 472985631, 936714852, 581623479. Mesatar: 483179562, 716523984, 259864371, 972386415, 348915627, 561742893, 124638759, 697451238, 835297146.



Unë dhe të pasurit tjerë nuk e meritojmë këtë fat!

Bill Gates deklaroi se kishte paguar shumë pak taksa dhe se nuk e meritonte të ishte aq i pasur. 63 vjeçari, i cili ka pasuri rreth 73 bilionë dollarë, tha se ai dhe të pasurit e tjerë në biznese duhet të duhet të kontribuojnë më shumë. Në një intervistë për Daily Mail, ai tha se ka paguar më shumë se 10 miliardë dollarë për taksat, por se do të duhet të paguaj më shumë. "Më shumë se e kam ndjekur ligjin, por mendoj se gjërat duhet të jenë më progresive". Gates bëri pasuri multi-miliardëshe pas themelimit të Microsoft në vitin 1975. Tani është një nga kompanitë më të vlefshme në botë. Gates është një nga bilionerët e rrallë i cili u zotua që ta lë shumicën e pasurisë së tij për njerëzit në nevojë, e jo t'ua trashëgojë fëmijëve të tij. Me gruan e tij 54-vjeçare, ai drejton Fondacionin "Bill & Melinda Gates", që është i përkushtuar për të luftuar varfërinë dhe sëmundjet në vendet e varfra. "Unë nuk e meritoj pasurinë time. Askush nuk e meriton. Ka ardhur përmes kohës, fatit dhe përmes njerëzve me të cilët punova dhe me siguri punova shumë dhe Software ka qenë një gjë e dobishme që kam përfituar prej tij", tha Gates. Ai u shpreh se organizata të tjera që do të kenë nevojë për financim të mëtejshëm këtë vit do të përfshijnë Fondin Global për Luftën kundër SIDA, Tuberkulozit, Malariae, dhe Gavi, e cila përmirëson aksesin ndaj vaksinave tek fëmijët në vendet e varfra, dhe ai gjithmonë do të përkrahë financiarisht fondacionet që kërkojnë ndihmë.

NJERIU E DO QENIN SI FËMIJËN, TASHMË E THOTË EDHE SHKENCA

"Nuk më habit, çdo ditë në klinikën time kam dëshmi se sa e veçantë është marrëdhënia e qenit dhe pronarit. Kur kam komunikuar me pronarët, u drejtohem atyre sikur t'u flisja për fëmijën e tyre", thotë Marco Melosi, president i shoqatës kombëtare mjekësore veterinarë



Studiuesit japonezë kanë matur sasinë e oksitocinës në urinën e zotëve që përqafojnë kafshën e tyre dhe kanë arritur në përfundim se është e njëjtë kur ata e përqafojnë fëmijën. Macet nuk marrin të njëjtin efekt, ata janë në vendin e dytë. Adhuresit e maceve do të ndihen keq, por duhet të pranojnë vendimin e shkencës. Midis njeriut dhe qenit ka një marrëdhënie shumë të veçantë, jo të krahasueshme me kafshët e tjera, madje as me macet, të cilat renditen në vendin e dytë. Dashuria midis qenve dhe mjeshtërve të tyre është aq e thellë sa krahasohet me dashurinë midis prindit dhe fëmijës. Pikërisht kështu. Kjo është demonstruar nga hulumtimi i Universitetit Azabu, Japoni, ku Profesor Miho Nagasawa vuri re se çfarë ndodh kur një njeri dhe një qen përkëdhelen dhe përqafohen. Ai mbylli 21 çifte në një dhomë dhe ndoqi rrugën e lidhjes midis dy bipedëve dhe katërkëmbë-

sheve. Pastaj mati sasinë e oksitocinës, hormoni i dashurisë në urinën mashkullore dhe u zbulua se sasia e njëjtë prodhohet kur babai ose nëna e përqafojnë fëmijën.

"Nuk më habit, çdo ditë në klinikën time kam dëshmi se sa e veçantë është marrëdhënia e qenit dhe pronarit. Kur kam komunikuar me pronarët, u drejtohem atyre sikur t'u flisja për fëmijën e tyre", thotë Marco Melosi, president i shoqatës kombëtare mjekësore veterinarë. Shkenca konfirmon atë që është nënvizuar nga një hulumtim i Eurispes. Italianët vazhdojnë të shpenzojnë për kafshët e tyre. Ndoshta ata kursejnë në gjëra të tjera, por të sakrifikojnë jetën e kafshëve, as që bëhet fjalë. 76.8% i konsiderojnë kafshët si anëtarë aktualë të familjes, 6 nga 10 i konsiderojnë ata shokët e tyre më të mirë. Numri i njerëzve që rritin më shumë se një kafshë në shtëpi është në rritje.

SHQIPËRIA, SHTETI I DYTË MË I PADOBISHËM NË EVROPË

Në një klasifikim të 153 shteteve të botës sipas kontributit të gjithsecilit në zhvillimin dhe të mirën e njerëzimit, Shqipëria renditet e 70-ta, nga vendi i 69-të i një viti më parë. Pra, Shqipëria është vendi i parafundit në Europë, çka do të thotë se, është shteti evropian më "i padobishëm" pas Ukrainës dhe se ka kontributin më të vogël në zhvillimin e njerëzimit.

Indeksi i "vendeve të mira" përpilohet mbi bazën e kriterëve si: Shkenca dhe Teknologjia, kultura, paqja, rendi botëror, klima, barazia, shëndeti dhe mirëqenia. Ndërsa, padiskutim që ajo që i referohet shëndetit dhe prosperitetit është një njollë e zezë, pasi në rendit në vendin e 142-të në botë, ndër 153 shtete, madje edhe më keq se vende mjaft të pazhvilluara të Afrikës, Amerikës Latine apo edhe Azisë Juglindore. Kjo performancë e dobët vjen si rrjedhojë e nën-indikatorit që i referohet



ndihmës humanitare dhe donacioneve. Një tjetër indikator që na rendit ndër vendet e fundit në botë është ai që i referohet shkencës dhe teknologjisë.

Në këtë drejtim, Shqipëria është e 119-ta në botë, në rënie të ndjeshme në krahasim me vitin paraardhës. Indikatorët që kanë një vlerësim pozitiv ndërkohë janë ata që i referohen prosperitetit dhe barazi-

së si dhe ai i kulturës. Pra, në drejtim të kulturës, Shqipëria renditet e 54-ta në botë, Të paktën në këtë drejtim vlerësohet si një shtet që i jep diçka njerëzimit, madje edhe më shumë se Rusia, Turqia, Kina, etj. Në nivel global, kurorën e shtetit më të mirë e merr Finlanda, që ndiqet nga Irlanda dhe Suedia, ndërkohë që në vend të fundit renditet Iraku me Libinë dhe Jemenin.

1129 - Jerusalemi pushtohet nga Perandori Fredriku II.

1332 - Amda Sejon I, Perandori i Etiopisë fillon kampanjën e tij në Provincat jugore myslimane.

1536 - Franca dhe Turqia nënshkruajnë marrëveshje ushtarake dhe tregtare kundër Mbretit Karl.

1797 - Trinidadit okupohet nga Flota britanike nën komandën e Sir Ralph Abercromby.

1828 - Më shumë se 100 anije shkatërrohen nga stuhia në Gjibraltar.

1861 - Mbreti Viktor Emanuel I i Sardenjës bëhet Mbreti i parë i Italisë.

1884 - Policia konfiskon të gjitha kopjet e librit të Tolstojt "Në çka besoj".

1900 - Themelohet klubi i Ajaksit në Amsterdam.

1915 - Gjermani fillon bllokadat ndaj Anglisë.

1921 - Trupat britanike okupojnë Dublinin.

1927 - SHBA dhe Kanada fillojnë marrëdhënie diplomatike.

1930 - Astronauti amerikan Clyde Tombaugh zbulon Plutonin.

1932 - Japonia shpall Manxhurinë të pavarur.



25-VJEÇARJA SJELL NË JETË SHTATËNJAK

Një nënë është në gjendje të mirë shëndetësore pasi ka lindur natyrash shtatë fëmijë, gjashtë vajza dhe një djalë. 25-vjeçarja, emri i të cilës nuk është bërë i ditur, ka lindur në një spital në Diyali të Irakut dhe besohet se është gruaja e parë në Lindjen e Mesme që lind shtatnjak. Zëdhënësi i spitalit ka bërë të ditur se nëna dhe fëmijët janë në gjendje të mirë shëndetësore. Babai Youssef Fadl ka thënë se nuk e kanë pasur ndërmend të zgjerojnë familjen dhe se tani kanë dhjetë fëmijë. Shtatnjakët e parë në botë kanë lindur në Iowa gjatë vitit 1997.



Ekziston ai lloj njeriu që i bën njerëzit e tjerë të ndihen të vegjël. Por njeriu vërtetë i madh, është ai që i bën të gjithë pranë tij të ndihen të mëdhenj.

(Gilbert Keith Chesterton)